

32008L0050

**Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit
e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën”**

Gazeta Zyrtare L 152 , 11/06/2008 Fq. 0001 - 0044

Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit
e 21 Majit 2008 mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën”

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN ,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian dhe veçanërisht
nenin 175 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (1),

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit të Rajoneve,(2)

Duke vepruar në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 251 të Traktatit (3)

Duke pasur parasysh se:

(1) Programi, Veprimi i Gjashtë i Mjedisit të Komunitetit, miratuar nga Vendimi
nr. 1600/2002/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 22 Korrikut 2002 (4)
përcakton nevojën për pakësimin e ndotjes në nivelet të cilat minimizojnë efektet e
dëmshme për shëndetin e njeriut, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë
popullimeve të ndjeshme dhe mjedisit në tërësi, për të përmirësuar monitorimin dhe
vlerësimin e cilësisë së ajrit duke përfshirë depozitimin e elementëve ndotës dhe për
të dhënë informacion për publikun.

(2) Me qëllim për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin në tërësi, është
veçanërisht e domosdoshme të luftohet lëshimi i ndotësve që në vendburim dhe të
identifikohen dhe zbatohen masat më efikase për reduktimin e çlirimit të ndotësve në
nivel lokal, kombëtar dhe komunitar. Prandaj, çlirimi i ndotësve të dëmshëm të ajrit
duhet të menjanohet, parandalohet apo zvogëlohet dhe të përcaktohen objektivat e
duhura për një cilësi të lartë të ajrit, duke pasur parasysh standardet, udhëzimet dhe
programet përkatëse të Organizatës Botërore të Shëndetit.

(3) Direktiva e Këshillit 96/62/KE, e 27 shtatorit 1996 mbi vlerësimin dhe
menaxhimin e cilësisë së ajrit të mjedisit (5), Direktiva e Këshillit 1999/30/KE e 22
prillit 1999 ,që lidhet me vlerat e limitit: të dioksidit të sulfurit, dioksidit të nitrogjenit
dhe oksideve të nitrogjenit, lëndëve të imëta dhe plumbit në ajër (6), Direktiva
2000/69/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 16 nëntorit 2000 lidhur me vlerat
e kufirit për benzinën dhe monoksidin e karbonit në ajrin e mjedisit (7), Direktiva
2002/3/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 12 Shkurtit 2002 lidhur me ozonin
në ajrin e mjedisit (8) dhe Vendimin e Këshillit 97/101/KE e 27 janarit 1997, që

përcakton këmbimin e ndërsjelltë të informacionit dhe të dhënave nga stacionet individuale dhe rrjetet të cilat matin ndotjen në ajrin e mjedisit brenda Shteteve Anëtare (9) nevojitet të rishikohet në thelb, me qëllim përfshirjen e zhvillimeve të fundit shkencore dhe shëndetësore dhe eksperiencën e Shteteve Anëtare. Me synim qartësimin, thjeshtimin dhe efikasitetin administrativ, është e nevojshme që këto pesë akte të zëvendësohen nga një direktivë e vetme dhe, ku të jetë e përshtatshme, nga masat zbatuese.

(4) Pas krijimit të eksperiencës në lidhje me zbatimin e Direktivës 2004/107/KE së Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 15 Dhjetorit 2004 lidhur me arsenikun, kadmiumin, mërkurin, nikelin dhe hidrokarbonet aromatikë policiklik në ajrin e mjedisit (1) vëmendje duhet t'i kushtohet mundësisë për shkrirjen e këtyre dispozitave me ato të kësaj Direktive.

(5) Duhet të zbatohet metoda e përbashkët për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit, në bazë të kriterit të vlerësimit të përbashkët. Kur të vlerësohet cilësia e ajrit të ambientit, duhet të merret parasysh madhësia e popullsisë dhe ekosistemet e ekspozuara ndaj ndotjes së ajrit. Kështu, është i nevojshëm klasifikimi i territorit të secilit Shtet Anëtar në zona apo grupime të popullsisë, ku të reflektohet dendësia e popullatës.

(6) Të përdoren ku të jetë e mundur teknikat e modelimit për të mundësuar interpretimin e të dhënave mbi vendin, për sa i takon shpërndarjes dhe përqendrimit gjeografik.

Kjo mund të shërbejë si bazë për përlogaritjen e ekspozimit kolektiv të popullsisë që jeton në atë zonë.

(7) Me qëllim garantimin se informacioni i mbledhur mbi ndotjen e ajrit përfaqëson dhe krahason në mënyrë të mjaftueshme mbarë Komunitetin, është e rëndësishme, që për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis, të përdoren teknika standarde matëse dhe kriteret të përbashkëta për numrin dhe vendndodhjen e stacioneve matëse. Teknika të tjera përveç matjeve mund të përdoren për të vlerësuar cilësinë e ajrit të mjedisit; kështu është e domosdoshme të përcaktohen kriteret për përdorimin dhe saktësinë e këtyre teknikave.

(8) Duhet të bëhen matje të detajuara të lëndëve të imëta shkëputëse në mjediset rurale, me qëllim që të kuptohen më mirë ndikimet e këtij ndotësi dhe të parashikohen politikat përkatëse. Këto matje duhet të bëhen në përputhje me programin e përbashkët për vëzhgimin dhe vlerësimin e transmetimit në territor të gjerë të ndotësve të ajrit në Evropë (EMEP), përcaktuar në bazë të Konventës 1979 mbi Ndotjen e Gjerë ndërkufitare, miratuar nga Vendimi i Këshillit 81/462/KEE e 11 qershorit 1981 (2).

(9) Gjendja e cilësisë së ajrit duhet të ruhet kur është aktualisht e mirë ose e përmirësuar. Nëse nuk arrihen objektivat për cilësinë e ajrit të mjedisit të parashikuara në këtë Direktivë, Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin veprime me qëllim përputhjen me vlerat e lejuara dhe nivelet e rrezikshme, dhe ku të jetë e mundur, të arrihen vlerat e synuara dhe objektivat afatgjata.

(10) Rreziku që paraqitet nga ndotja ndaj ekosistemeve natyrore dhe bimësisë, është më i rëndësishëm në zonat larg qendrave të banuara. Vlerësimi i rreziqeve të tilla dhe përputhja me nivelet e rrezikshme për mbrojtjen e bimësisë, duhet për pasojë të fokusohet në vendet larg zonave urbane.

(11) Lënda e imët shkëputëse (PM2.5) është përgjegjëse për ndikimet domethënëse negative në shëndetin e njeriut. Për më tepër, ende nuk është gjendur ndonjë prag i identifikueshëm poshtë të cilit PM2.5 nuk do të paraqiste rrezik. Si i tillë, ky ndotës nuk do të trajtohet në mënyrë të njëjtë me ndotësit e tjerë të ajrit. Metoda duhet të ketë për qëllim reduktimin e përqendrimit në mjedisin urban për të garantuar që zona të gjera popullore të përfitojnë nga cilësia e përmirësuar e ajrit. Megjithatë, për të garantuar kudo një shkallë minimale mbrojtje, kjo metodë duhet të kombinohet me një vlerë të lejuar, e cila duhet të paraprihet në fazën e parë nga një vlerë e synuar.

(12) Vlerat ekzistuese të synuara dhe objektivat afatgjata për garantimin e mbrojtjes efektive kundër efekteve të dëmshme për shëndetin e njeriut, bimësinë dhe ekosistemet nga ekspozimi ndaj ozonit, duhet të mbeten të pandryshuara. Duhet të përcaktohet një kufi paralajmërues dhe një kufi informacioni për ozonin për mbrojtjen e popullsisë në përgjithësi dhe rajoneve të ndjeshme, përkatësisht, nga ekspozimet e masave të vogla deri në përqendrime të larta të ozonit. Këto kufij duhet të nxisin përhapjen e informacionit për publikun mbi rrezikun e ekspozimit dhe zbatimit, nëse është e nevojshme, të masave afatshkurtra për uljen e niveleve të ozonit kur kalohet kufiri paralajmërues.

(13) Ozoni është një ndotës ndërkufitar i formuar në atmosferë nga çlirimi i ndotësve primarë adresuar nga Direktiva 2001/81/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshilli, e 23 Tetorit 2001 mbi kufirin e rrezatimit kombëtar për disa ndotës atmosferikë (3). Progresi ndaj synimeve për cilësinë e ajrit dhe objektiveve afatgjata për ozonin, përcaktuar në këtë Direktivë, duhet të përcaktohet nga planet dhe kufiri i rrezatimit parashikuar në Direktivën 2001/81/KE dhe nëse është e nevojshme, nga zbatimi i planeve për cilësinë e ajrit parashikuar në këtë Direktivë.

(14) Masat e caktuara duhet të jenë detyruese në zonat dhe qendrat urbane kur objektivat afatgjata për ozonin apo vlerësimi i kufijve për ndotësit e tjerë të jenë tejkaluar. Informacioni nga masat e caktuara mund të plotësohet me anë të teknikave të modelimit dhe/ose masave treguese për të mundësuar që të dhënat mbi vendin të interpretohen për sa i takon shpërndarjes gjeografike të përqendrimeve. Përdorimi i teknikave plotësuese të vlerësimit, do të lejojë gjithashtu reduktimin e numrit minimal të kërkuar në vende të marra për krahasim.

(15) Kontributet nga burimet natyrore mund të vlerësohen por jo të kontrollohen. Prandaj, kur kontributet natyrore ndaj ndotësve në ajrin e mjedisit mund të përcaktohen me siguri të mjaftueshme, dhe, kur tejkalimet i takojnë tërësisht apo pjesërisht këtyre kontributeve natyrore, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Direktivë, ato mund të zbriten gjatë vlerësimit të përputhjes me vlerat e lejuara të cilësisë së ajrit. Kontributet ndaj tepërive të lëndëve shkëputëse PM10 vlerave të lejuara që i atribuohen mbulimit të rrugëve me rërë apo kripë gjatë dimrit mund të zbriten gjithashtu kur vlerësohet përputhja me vlerat e lejuara të cilësisë së ajrit, me kusht që të jenë marrë masat e përshtatshme për uljen e përqendrimit. Për zonat dhe grupimet ku kushtet janë shumë të vështira, duhet të jetë e mundur të shtyhen afatet

për përputhjen me vlerat e lejuara të cilësisë së ajrit, ku pavarësisht nga zbatimi i masave të duhura nxitëse të ndotjes, ekzistojnë probleme të mprehta përputhshmërie në zona dhe grupime të veçanta. Çdo shtyrje për një zonë apo grupim duhet të shoqërohet nga një plan gjithëpërfshirës që do të vlerësohet nga Komisioni për të garantuar përputhjen me afatin e fundit të korrigjuar. Vlefshmëria e masave të domosdoshme të Komunitetit që reflektojnë nivelin e qëllimit të zgjedhur në Strategjinë Tematike mbi ndotjen për të zvogëluar rrezatimin që në origjinë, do të jetë e rëndësishme për një zvogëlim efikas të rrezatimit brenda afatit të përcaktuar në këtë direktive për përputhjen me vlerat e lejuara dhe duhet të merren parasysh, kur vlerësohen kërkesat për shtyrjen e afateve përfundimtare për përputhshmëri.

(17) Duhet të analizohen si duhet, si prioritet nga gjithë institucionet e përfshira, masat e domosdoshme Komunitare për të zvogëluar çlirimin në burim, në veçanti masat për përmirësimin e efikasitetit të legjislacionit Komunitar në lidhje me ndotjen industriale, për të kufizuar çlirimin e tymrave të motorrave instaluar në mjetet e transportit të rëndë, për të zvogëluar më tej masën e lejuar të ndotësve kryesorë në nivel kombëtar nga Shtetet Anëtare si edhe ndotësit lidhur me mbushjen me karburant të makinave me naftë në pikat e karburantit, si edhe të trajtimit të përmbajtjes së sulfurit në karburante përfshirë ato detare.

(18) Duhet të zhvillohen plane për cilësinë e ajrit për zona dhe grupime, brenda të cilave, përqendrimi i ndotësve në ajrin e mjedisit i kalon vlerat e synuara për cilësinë e ajrit apo vlerat kufi, me ndonjë kufi të përkohshëm tolerance, atje ku kjo është e zbatueshme. Ndotësit e ajrit çlirohen nga shumë aktivitete e burime të ndryshme. Për të siguruar njëtrajtshmëri midis politikave të ndryshme, plane të tilla për ajrin duhet, ku është e mundur, të jenë të njëtrajtshme dhe të integruara me planet dhe programet e përgatitura në vijim të Direktivës 2001/80/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 23 tetorit 2001, mbi kufizimin e çlirimit të ndotësve të caktuar nga fabrika të mëdha djegieje (1), dhe Direktivës 2001/81/KE, dhe Direktivës 2002/49/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 25 qershorit 2002, lidhur me përlogaritjen dhe menaxhimin e zhurmës së mjedisit (2). Do të merren, gjithashtu, tërësisht në konsideratë objektivat e cilësisë së ajrit të ambientit parashikuar në këtë Direktivë, atje ku janë garantuar leje për aktivitete industriale sipas Direktivës 2008/1/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 15 janarit 2008, në lidhje me ndalimin dhe kontrollin e ndotjes së integruar (3).

(19) Duhet të hartohen plan aksione, që tregojnë masa, të cilat do të merren në afate të shkurtra, atje ku ka rrezik kalimi të një apo më shumë pragjeve të alarmit, në mënyrë që të zvogëlohet ky rrezik dhe të kufizohet kohëzgjatja e tij. Kur rreziku ka të bëjë me një ose më shumë vlera kufi apo vlera të synuara, Shtetet Anëtare mundet, sipas përshtatshmërisë, të hartojnë me shkrim plane veprimi të tilla afatshkurtra. Në lidhje me ozonin, plane veprimi të tilla afatshkurtra duhet të marrin parasysh parashikimet e Vendimit të Komisionit 2004/279/KE e 19 marsit 2004, në lidhje me udhëzimet për zbatimin e Direktivës 2002/3/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me ozonin në ajrin e mjedisit (4).

(20) Shtetet Anëtare duhet të konsultohen me njeri-tjetrin, nëse në vijim të një ndotje të konsiderueshme me origjinë nga një Shtet tjetër Anëtar niveli i ndotësve kapërcen ose ka gjasa të kapërcejë objektivat përkatëse të cilësisë së ajrit duke shtuar dhe kufirin e tolerancës, atje ku kjo është e zbatueshme, apo sipas rastit, dhe prapun

e alarmit. Natyra ndërkufitare e disa ndotësve si ozoni dhe lënda shkëpuëse, mund të kërkojë bashkëpunim midis Shteteve Anëtare fqinje në hartimin me shkrim dhe zbatimin e planeve për cilësinë e ajrit, plane veprimi afatshkurtra, dhe në informimin e publikut. Atje ku është e përshtatshme, Shtetet Anëtare duhet të ndjekin bashkëveprim me vendet e treta, me theks të veçantë, në përfshirjen e hershme të vendeve kandidatë.

(21) Është e rëndësishme për Shtetet Anëtare dhe Komisionin të mbledhin, këmbëjnë dhe përhapin informacion për cilësinë e ajrit, në mënyrë që të kuptojnë më mirë ndikimet e ndotjes së ajrit dhe të zhvillojnë politika të përshtatshme. Informacioni i përditësuar në lidhje me përqendrimin e gjithë ndotësve, përfshirë në rregullore, në ajrin e mjedisit duhet të jetë i vlefshëm për publikun.

(22) Në mënyrë që të lehtësohet menaxhimi dhe krahasimi i informacionit për cilësinë e ajrit, duhet të bëhen të mundura për Komisionin të dhëna në formë standarde.

(23) Është e domosdoshme të miratohen procedura për sigurimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e ajrit, që të mundësohet përdorimi i internetit dhe i mjeteve elektronike si veglat kryesore për mundësimin e informacionit, në mënyrë që procedura të tilla të jenë në përputhje me Direktivën 2007/2/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 14 marsit 2007, që përcakton infrastrukturën e informacionit hapësinor për Komunitetin Evropian (INSPIRE) (5).

(24) Është e vlefshme të parashikohet mundësia e përshtatjes së kritereve dhe teknikave që do të përdoren për llogaritjen e cilësisë së ajrit në mjedis, me progresin shkencor dhe teknik për t'u përshtatur në këtë mënyrë informacioni i siguruar.

(25) Duke qenë se objektivat e kësaj Direktive nuk mund të arrihen mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare, për arsye të natyrës ndërkufitare të ndotësve të ajrit dhe si pasojë mund të arrihen më mirë në nivel Komunitar, Komuniteti mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit siç është parashikuar në nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e përpjestueshmërisë, siç është parashikuar në atë nen, kjo Direktivë nuk shkon përtej asaj që është e domosdoshme me qëllim për të arritur ato objektiva.

(26) Shtetet Anëtare duhet të vendosin ligje për gjopa të zbatueshme ndaj shkeljeve të dispozitave të kësaj Direktive dhe të sigurojnë që ato të zbatohen. Gjopat duhet të jenë efikase, të përpjesëtuara dhe me efekt mospërsëritje të shkeljes.

(27) Dispozita të caktuara të akteve të shfuqizuara nga kjo Direktivë duhet të mbeten në fuqi, në mënyrë që të sigurojnë vazhdimësinë e kufijve ekzistues për cilësinë e ajrit në lidhje me dyoksidin e nitrogjenit deri sa të zëvendësohen, më 1 janar 2010, vazhdimësinë e dispozitave për raportimin e cilësisë së ajrit deri sa të përshtaten masa të reja zbatimi dhe vazhdimësinë e detyrimeve lidhur me përlogaritjen paraprake të cilësisë së ajrit, të detyrueshme sipas Direktivës 2004/107/KE.

(28) Detyrimi për ta shndërruar këtë Direktivë në ligj kombëtar duhet të kufizohet brenda dispozitave që përfaqësojnë ndryshim të rëndësishëm, krahasuar me Direktivat e mëparshme.

(29) Në përputhje me pikën 34 të Marrëveshjes Ndërinstitucionale për ligjbërje më të mirë (1), inkurajohen Shtetet Anëtare të hartojnë me shkrim, për veten e tyre dhe në interes të Komunitetit, tabela që ilustron, me sa të jetë e mundur, lidhjen midis Direktivës dhe masave shndërruese si edhe t'i bëjnë ato të përgjithshme, ndërkombëtare.

(30) Kjo Direktivë respekton të drejtat themelore dhe merr parasysh parimet e njohura, në veçanti, sipas Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Në mënyrë të veçantë, kjo Direktivë kërkon të nxisë integrimin në politikat e Bashkimit të një niveli të lartë mbrojtjeje mjedisi dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, siç është parashikuar në nenin 37 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

(31) Masat e domosdoshme për zbatimin e kësaj Direktive, duhen miratuar në përputhje me vendimin e Këshillit 1999/468/KE, e 28 qershorit 1999, që parashtron procedurat për ushtrimin e fuqive zbatuese që i janë ngarkuar Komisionit (2).

(32) Komisioni duhet të autorizohet të ndryshojë Shtojcat I deri në VI, Shtojcat VIII deri në X dhe Shtojcën XV. Duke qenë se masat kanë qëllim të përgjithshëm dhe janë skicuar të ndryshojnë elementet jothelbësore të kësaj Direktive, ato duhet të miratohen me kujdes të veçantë në përputhje me procedurën rregulluese, parashikuar në nenin 5 pika (a) të Vendimit 1999/468/KE.

(33) Klauzola shndërruese kërkon nga Shtetet Anëtare të sigurojnë që masat e domosdoshme urbane të jenë në vendin e në kohën e duhur për të përkufizuar Treguesin Mesatar të Ekspozimit, në mënyrë që të garantohet përmbushja e kërkesave lidhur me përlllogaritjen e Synimit të Zvogëloimit të Ekspozimit Kombëtar dhe me llogaritjen e Treguesit Mesatar të Ekspozimit,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përmbajtja

Kjo Direktivë përcakton masat që synojnë si më poshtë vijon:

1. përcaktimin dhe krijimin e objektivave për cilësinë e ajrit të mjedisit hartuar në mënyrë të tillë, që të shmangin dhe të parandalojnë apo zvogëlojnë efektet e dëmshme në shëndetin e njerëzve dhe në mjedisin në tërësi;
2. përlllogaritjen e cilësisë së ajrit të mjedisit në Shtetet Anëtare në bazë të metodave dhe të kriterëve të përbashkëta;

3. sigurimin e informacionit mbi cilësinë e ajrit të mjedisit, në mënyrë që të ndihmojë luftën kundër ndotjes dhe shqetësimit të ajrit dhe të vëzhgojë prirjet dhe përmirësimet që vijnë si rezultat i masave kombëtare dhe të Komunitetit;
4. garantimin se informacioni i tillë mbi cilësinë e ajrit të mjedisit do t'i bëhet i mundshëm publikut;
5. mirëmbajtjen e cilësisë së ajrit atje ku është e mirë dhe përmirësimin e saj në raste të tjera;
6. nxitjen e rritjes së bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare për zvogëlimin e ndotjes së ajrit.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Direktive:

1. 'ajër i mjedisit' nënkupton ajër jashtë në troposferë, me përjashtim të vendeve të punës siç është përkufizuar nga Direktiva 89/654/KEE (3), për të cilat zbatohen dispozitat për ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe për të cilat anëtarë të publikut nuk kanë hyrje të rregullt;
2. 'ndotës' nënkupton çdo substancë të pranishme në ajrin e mjedisit dhe që ka gjasa të shkaktojë dëm në shëndetin e njerëzve dhe/ose mjedisin në tërësi;
3. 'nivel' nënkupton përqendrimin e një ndotësi në ajrin e mjedisit ose depozitimim e këtij ndotësi në sipërfaqe në një kohë të caktuar;
4. 'përllogaritje' nënkupton çfarëdo metodë të përdorur për të matur, llogaritur, parashikuar apo vlerësuar nivelet;
5. 'vlera kufi' nënkupton një nivel të përcaktuar mbi bazën e njohjes shkencore, me qëllim shmangien, parandalimin apo zvogëlimin e efekteve të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin në tërësi, që do të arrihet në një periudhë të dhënë dhe ku nuk do të kapërcehet nga momenti që arrihet;
6. 'nivel kritik' nënkupton një nivel i përcaktuar mbi bazën e njohjes shkencore, mbi të cilin mund të ndodhin efekte të papëlqyera të drejtpërdrejta në ndjesorë të tillë, si: pemë, bimë të tjera ose ekosisteme natyrore, por jo në njerëz;
7. 'kufiri i tolerancës' nënkupton përqindjen e vlerës kufi me të cilën ajo vlerë do të kapërcehet si objekt i kushteve të parashtruara në këtë Direktivë;
8. 'plane të cilësisë së ajrit' nënkupton plane që caktojnë masa për të arritur vlerat kufi ose vlerat e synuara;
9. 'vlera e synuar' nënkupton një nivel të caktuar me qëllimin e shmangies, parandalimit ose zvogëlimit të efekteve të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin në tërësi, për t'u arritur ku të jetë e mundur në një periudhë të dhënë;
10. 'pragu i alarmit' nënkupton nivelin përtej të cilit është një rrezik ndaj shëndetit njerëzor nga ekspozime të shkurtra për popullsinë në tërësi dhe për të cilin duhet të merren masa të menjëhershme nga Shtetet Anëtare;

(3) Direktivë e Këshillit 89/654/KEE datë 30 nëntor 1989 në lidhje me kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për vendin e punës (GZ L 393, 30.12.1989, fq. 1). Direktivë e ndryshuar sipas Direktivës 2007/30/KE së Parlamentit Evropian dhe Këshillit (GZ L 165, 27.6.2007, fq. 21).

11. 'pragu i informacionit' nënkupton një nivel përtej të cilit ka rrezik për shëndetin e njeriut nga ekspozimi i shkurtër për atë pjesë të popullsisë, veçanërisht, të ndjeshme dhe për të cilat nevojitet informacion i menjëhershëm dhe i përshtatshëm;

12. 'pragu i përlogaritjes së lartë' nënkupton një nivel nën të cilin mund të përdoren një kombinim masash të vendosura dhe teknikash modeluese dhe/ose masa treguese, për të përlogaritur cilësinë e ajrit;
13. 'pragu i përlogaritjes së ulët' nënkupton një nivel nën të cilin mund të përdoren vetëm teknika modelimi ose vlerësimi objektivash për të përlogaritur cilësinë e ajrit të mjedisit;
14. 'objektivë afatgjatë' nënkupton një nivel që do të arrihet në afat të gjatë, me përjashtim të rasteve kur nuk është e arritshme nëpërmjet masave përpjesëtuuese, me qëllim sigurimin e mbrojtjes efikase të shëndetit publik dhe mjedisit;
15. 'kontribute nga burimet natyrore' nënkupton çlirimi i ndotësve jo të shkaktuar direkt apo indirekt nga aktivitet njerëzore, përfshirë ngjarje natyrore, si : shpërthime vullkani, aktivitete sizmike, aktivitete geotermale, zjarre në toka të hapura, erë e fortë, spërkatje deti ose ridepozitim apo transport i materialeve të imëta natyrore nga rajone të thata;
16. 'zonë' nënkupton pjesë të territorit të një Shteti Anëtar, kufizuar nga ai Shtet Anëtar me qëllim përlogaritjen dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit;
17. 'grupim' nënkupton një zonë, që është qark, me popullsi me më shumë se 250 000 banorë ose kur popullsia është 250 000 banorë ose më pak, me një denduri popullore të dhënë për km², e përcaktuar nga Shtetet Anëtare;
18. 'PM10' nënkupton lëndë shkëputëse që kalon përmes kanalit që bën përzgjedhjen e madhësisë, siç është përkufizuar në metodën referencë për kampionet dhe matjen e PM10, EN 12341, me 50 % efikasitet shkëputje në 10 µm diametër aerodinamik;
19. 'PM2,5' nënkupton lëndë shkëputëse që kalon përmes një kanali që bën përzgjedhjen e madhësisë, siç është përkufizuar në metodën referencë për kampionet dhe matjen e PM2,5, EN 14907, me 50 % efikasitet shkëputje në 2.5 µm diametër aerodinamik;
20. 'tregues ekspozimi mesatar' nënkupton një nivel mesatar i përcaktuar në bazë të matjeve në vendndodhjet me sfond urban nëpër tërë territorin e një Shteti Anëtar që pasqyron ekspozimin e popullsisë. Përdoret për të llogaritur synimin e reduktimit të ekspozimit kombëtar si edhe detyrimin e përqendrimit të ekspozimit;
21. 'detyrimi i përqendrimit të ekspozimit' nënkupton një nivel i përcaktuar në bazë të treguesit mesatar të ekspozimit, me qëllim zvogëlimin e efekteve të dëmshme në shëndetin e njeriut, që do të arrihen në një periudhë të dhënë;
22. 'synimi i zvogëlimit të ekspozimit kombëtar' nënkupton një zvogëlim në përqindje të ekspozimit mesatar të popullsisë së një Shteti Anëtar vendosur për vitin, që do të merret si referencë me qëllim zvogëlimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut, për t'u arritur atje ku është e mundur në një periudhë të dhënë;
23. 'vendndodhje me sfond urban' nënkupton vende me qendra urbane ku nivelet janë përfaqësuese në ekspozimin e popullsisë së përgjithshme urbane;
24. 'okside nitrogjeni' nënkupton shumën e raportit të përzierjes së volumit (ppbv) të monoksidit të nitrogjenit (oksid nitrik) dhe dyoksidit të nitrogjenit, shprehur në njësi të përqendrimit në masë të dyoksidit të nitrogjenit (µg/m³);
25. 'masa të përcaktuara' nënkupton përmasa, të marra në vende të caktuara ose vazhdimisht, ose kampione të çfarëdoshme për të përcaktuar nivelet në përputhje me objektivat e cilësisë në të dhënat përkatëse;
26. 'përmasa treguese' nënkupton përmasa që përmbushin objektivat e cilësisë së të dhënave që janë më pak të sakta sesa ato të kërkuarat për përmasa të përcaktuara;
27. 'Bashkime Organike të Shndërrueshme' (VOC) nënkupton bashkime organike nga burime biogjenike dhe antropogjenike, me përjashtim të metanit, që janë të afta të

prodhojnë oksiduesë fotokimikë nga reaksionet e oksidit të nitrogjenit në prani të dritës së diellit;

28. 'substancia pararendëse të ozonit' nënkupton substanca të cilat kontribuojnë në formimin e ozonit në nivel toke, disa prej të cilave janë listuar në Shtojcën X.

Neni 3

Përgjegjësitë

Shtetet Anëtare do të caktojnë ndaj niveleve përkatëse të autoriteteve dhe njërive kompetente përgjegjëse për sa vijon:

- (a) përlllogaritje të cilësisë së ajrit të mjedisit;
- (b) aprovim të sistemeve të përmasave (metoda, pajisje, rrjete dhe laboratorë);
- (c) sigurim dhe saktësi të përmasave;
- (d) analiza të metodave të përlllogaritjes;
- (e) koordinim, në territorin e tyre nëse organizohen nga Komisioni, të programeve të sigurimit të cilësisë mbarë Komunitare;
- (f) bashkëveprim me Shtetet e tjera Anëtare dhe me Komisionin.

Në rastet e vlefshme, autoritetet dhe njësitë kompetente do të veprojnë në përputhje me Seksionin C të Shtojcës I.

Neni 4

Përcaktime zonash dhe grupimesh

Shtetet Anëtare do të përcaktojnë zona dhe grupime përgjatë gjithë territorit të tyre. Do të kryhet përlllogaritja e cilësisë së ajrit dhe menaxhimi i cilësisë së ajrit në të gjitha zonat dhe grupimet.

KAPITULLI II

PËRLLLOGARITJA E CILËSISË SË AJRIT TË MJEDISIT

SEKSIONI 1

Përlllogaritja e cilësisë së ajrit të mjedisit në lidhje: me dyoksidin e sulfurit, dyoksidin e nitrogjenit dhe oksidet e nitrogjenit, lëndë shkëputëse, plumb, benzinë dhe monoksid karboni

Neni 5

Regjimi i përlllogaritjes

1. Pragjet e përlllogaritjes së lartë dhe të ulët specifikuar në Seksionin A të Shtojcës II, do të zbatohen: për dyoksidin e sulfurit, dyoksidin e nitrogjenit dhe oksidet e nitrogjenit, lëndën shkëputëse (PM10 dhe PM2,5), plumbin, benzinën dhe monoksidin e karbonit.

Çdo zonë dhe grupim do të klasifikohet në lidhje me ato pragje përlllogaritjeje.

2. Klasifikimi i përmendur në paragrafin 1, do të rishikohet të paktën çdo pesë vjet, në përputhje me procedurën e parashtruar në Seksionin B të Shtojcës II.

Megjithatë, klasifikimet do të rishikohen më shpesh në rast ndryshimesh të konsiderueshme të aktiviteteve që lidhen me përqendrimit në mjedis: të dyoksidit të sulfurit, oksidit të nitrogjenit ose, atje ku kjo ka vlerë, okside nitrogjeni, lëndë shkëputëse (PM10, PM2,5), plumb, benzinë ose monoksid karboni.

Neni 6

Kritere përlllogaritjeje

1. Shtetet Anëtare do të përlllogaritin cilësinë e ajrit të mjedisit duke marrë parasysh ndotësit e përmendur në nenin 5, për të gjithë zonat dhe grupimet e tyre, në përputhje me kriteret parashtruara në paragrafin 2, 3 dhe 4 të këtij neni si dhe, në përputhje me kriteret parashtruara në Shtojcën III.

2. Në të gjitha zonat dhe grupimet ku niveli i ndotësve të përmendur në paragrafin 1 kapërcen pragun e përlllogaritjes së lartë, të përcaktuar për ata ndotës, do të përdoren masa të caktuara për të përlllogaritur cilësinë e ajrit të mjedisit. Këto masa të caktuara mund të plotësohen me teknika modelimi dhe/ose masa treguese, për të siguruar një informacion të përshtatshëm në shpërndarjen hapësinore të cilësisë së ajrit të mjedisit.

3. Në të gjitha zonat dhe grupimet ku niveli i ndotësve të përmendur në paragrafin 1 është nën pragun e përlllogaritjes së lartë, mund të përdoret një kombinim masash të caktuara dhe teknikash modelimi dhe/ose masash treguese për të përlllogaritur cilësinë e ajrit të mjedisit.

4. Në të gjitha zonat dhe grupimet ku niveli i ndotësve të përmendur në paragrafin 1 është nën pragun e përlllogaritjes së ulët, të përcaktuar për ata ndotës, do të ishin të mjaftueshme teknikat modeluese ose vlerësuese të objektivave, ose të dyja, , për përlllogaritjen e cilësisë së ajrit të mjedisit.

5. Shtuar përlllogaritjeve të përmendura në paragrafët 2, 3 dhe 4, do të bëhen matje në zona me sfond rural, larg nga burimet e konsiderueshme të ndotjes së ajrit, me qëllim sigurimin, së paku, të informacionit ndaj përqendrimit tërësor në masë dhe përqendrimeve të kimikateve të veçanta të lëndës së imët shkëputëse (PM2,5) me bazë mesatareje vjetore, ku do të kryhen duke përdorur kriteret e poshtëshënuara:

(a) do të instalohet një pikë kampionesh çdo 100 000 km²;

(b) çdo Shtet Anëtar do të ngrëjë të paktën një stacion matës ose, me marrëveshje me Shtetet Anëtare fqinje, mundet të ngrëjë një ose disa stacione matëse të përbashkëta që do të mbulojnë zonat fqinje përkatëse, për të arritur ndarjen e domosdoshme hapësinore;

(c) aty ku është e mundur, vëzhgimi do të bashkërendohet me programin e matjes dhe strategjisë së vëzhgimit të Programit Bashkëpunues për Vëzhgimin dhe Vlerësimin e Transmetimit në Gamë të Gjerë të Ndotësve të Ajrit në Evropë (EMEP);

(d) seksionet A dhe C të Shtojcës I, do të zbatohen në lidhje me objektivat e cilësisë së të dhënave për matjet e përqendrimit në masë të lëndëve të veçanta dhe Shtojca IV do të zbatohet në tërësinë e saj.

Shtetet Anëtare do të informojnë Komisionin e metodave të matjeve të përdorura në matjen e përbërjes kimike të lëndës së veçantë të imët (PM2,5).

Neni 7

Pikat e marrjes së kampioneve

1. Vendndodhjet e pikave të marrjes së kampioneve për matjen e dyoksidit të sulfurit, dyoksidit të nitrogjenit dhe oksideve të nitrogjenit, lëndës shkëputëse (PM10, PM2,5), plumbit, benzinës dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit, do të përcaktohen duke përdorur kriteret e listuara në Shtojcën III.

2. Në çdo zonë dhe grupim, ku matjet e caktuara janë i vetmi burim informacioni për përlllogaritjen e cilësisë së ajrit, numri i pikave të marrjes së kampioneve për çdo ndotës përkatës nuk do të jetë më pak se numri më i vogël i pikave të marrjes së kampioneve specifikuar në Seksionin A Shtojcës V.

3. Për zonat dhe grupimet, brenda të cilave, informacioni nga pika të caktuara matjeje të marrjes së kampioneve plotësohet me informacion nga modelimi dhe/ose masat treguese, numri total i pikave të marrjes së kampioneve, specifikuar në Seksionin A të Shtojcës V, mund të zvogëlohet me deri 50 %, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

(a) metodat plotësuese sigurojnë informacion të mjaftueshëm për matjen e cilësisë së ajrit duke marrë parasysh vlerat kufi të pragjeve të alarmit, si edhe informacionin e mjaftueshëm për publikun;

(b) numri i pikave për marrjen e kampioneve që do të instalohen dhe zgjidhja hapësinore e teknikave të tjera, janë të mjaftueshme për përcaktimin e përqendrimit të ndotësit përkatës në përputhje me objektivat e cilësisë së të dhënave, specifikuar në Seksionin A të Shtojcës I, dhe mundësojnë rezultatet e përlllogaritjes për të përmbushin kriteret specifikuar në seksionin B të Shtojcës I

Rezultatet e modelimit dhe/ose masave treguese, do të merren parasysh për përlllogaritjen e cilësisë së ajrit, duke pasur parasysh vlerat kufi.

4. Zbatimi i kriterëve në Shtetet Anëtare për përzgjedhjen e pikave të marrjes së kampioneve, do të monitorohet nga Komisioni në mënyrë që të lehtësojë zbatimin e harmonizuar të atyre kriterëve, në mbarë Bashkimin Evropian.

Neni 8

Metodat referencë të matjes

1. Shtetet Anëtare do të zbatojnë metodat dhe kriteret referencë të matjes, specifikuar në Seksionet A dhe C të Shtojcës VI.

2. Mund të përdoren metoda të tjera referencë sipas kushteve të përcaktuara në Seksionin B të Shtojcës VI.

SEKSIONI 2

Përlllogaritja e cilësisë së ajrit të mjedisit në lidhje me ozonin

Neni 9

Kritere përlllogaritjeje

1. Aty ku, në një zonë apo grupim, përqendrimet e ozonit kanë kapërcyer objektivat afatgjata të caktuara në Seksionin C të Shtojcës VII gjatë cilitdo prej pesë viteve të mëparshme të matjes, do të bëhen matje fikse.
2. Aty ku ka të dhëna të gatshme në më pak se pesë vite, Shtetet Anëtare, me qëllim përcaktimin nëse objektivat e përmendura në paragrafin 1 janë kapërcyer gjatë atyre pesë viteve, mundet t'i kombinojnë rezultatet, nga fushata matjeje me kohëzgjatje të vogël të kryera kur dhe ku nivelet kanë gjasa të jenë në vlerat më të larta të tyre, me rezultate të marra nga inventarë dhe modelime lëshimi.

Neni 10

Pikat e marrjes së Kampioneve

1. Vendi i pikave të marrjes së kampioneve për matjen e ozonit, do të përcaktohet duke përdorur kriteret e përcaktuara në Shtojcën VIII.
2. Pikat e marrjes së kampioneve për matje të përcaktuara të ozonit në çdo zonë ose grupim brenda të cilës matja është burimi i vetëm i informacionit për përlllogaritjen e cilësisë së ajrit, nuk do jenë më pak sesa numri më i vogël i pikave të marrjes së kampioneve specifikuar në Seksionin A të Shtojcës IX.
3. Për zona dhe grupime brenda të cilave informacioni nga pikat e marrjes së kampioneve për matje të përcaktuara plotësohet me informacion nga modelimi dhe/ose masat treguese, numri i pikave të marrjes së kampioneve specifikuar në Seksionin A të Shtojcës IX, mund të zvogëlohet nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:
 - (a) metodat plotësuese sigurojnë informacion të mjaftueshëm për përlllogaritjen e cilësisë së ajrit, duke pasur parasysh vlerat e synuara, objektivat afatgjata, pragjet e informacionit dhe të alarmit;
 - (b) numri i pikave të marrjes së kampioneve për t'u instaluar dhe ndarja hapësinore e teknikave të tjera, janë të mjaftueshme për përqendrimin e ozonit për t'u përcaktuar në përputhje me objektivat e cilësisë së të dhënave specifikuar në Seksionin A të Shtojcës I dhe mundësojnë rezultatet e përlllogaritjes për të përmbushur kriteret e specifikuar në Seksionin B të Shtojcës I;
 - (c) numri i pikave të marrjes së kampioneve në çdo zonë dhe grupim shkon së paku në një pikë për dy milionë banorë ose në një pikë për 50 000 km², cilado formë qoftë që do të nxjerrë më shumë pika të marrjes së kampioneve, nuk duhet të jetë më pak se një pikë marrjeje kampionesh në çdo zonë ose grupim;
 - (d) dyoksidi i nitrogjenit matet në të gjitha pikat e tjera, me përjashtim të stacioneve në sfonde rurale siç përmendet në Seksionin A të Shtojcës VIII.

Rezultatet e modelimit dhe/ose matjeve treguese do të merren parasysh për përlllogaritjen e cilësisë së ajrit në lidhje me vlerat e synuara..
4. Dyoksidi i nitrogjenit do të matet në një minimum prej 50 % të pikave kampion të ozonit, kërkuar sipas Seksionit A të Shtojcës IX. Kjo matje do të jetë e vazhdueshme me përjashtim stacionet me sfond rural, siç përmendet në Seksionin A të Shtojcës VIII, ku mund të përdoren metoda të tjera matjeje.
5. Në zona dhe grupime, ku, gjatë secilit prej pesë viteve të mëparshme të matjeve, përqendrimet janë nën objektivat afatgjata, numri i pikave të marrjes së kampioneve për matje të përcaktuara, do të përcaktohet në përputhje me Seksionin B të Shtojcës IX.

6. Secili Shtet Anëtar do të sigurohet se i është instaluar të paktën një pikë e marrjes së kampioneve dhe kjo vepron në territorin e tij për të grumbulluar të dhëna mbi përqendrimit e substancave pararendëse të ozonit të listuara në Shtojcën X. Secili Shtet Anëtar do të zgjedhë numrin dhe vendin e stacioneve ku do të maten substancat pararendëse të ozonit, duke marrë parasysh objektivat dhe metodat parashtruar në Shtojcën X.

Neni 11

Metodat referencë të matjes

1. Shtetet Anëtare do të zbatojnë metodën e referencës për matjen e ozonit, përcaktuar në pikën 8 të Seksionit A të Shtojcës VI. Mund të përdoren metoda të tjera matjeje në përputhje me kushtet e përcaktuar në Seksionin B të Shtojcës VI.
2. Secili Shtet Anëtar do të informojë Komisionin për metodat që përdor për të marrë kampione e për të matur VOC, siç është listuar në Shtojcën X.

KAPITULLI III MENAXHIMI I CILËSISË SË AJRIT TË AMBIENTIT

Neni 12

Kërkesat për rastet ku nivelet janë më të ulëta sesa vlerat kufi

Në zonat dhe grupimet ku nivelet e dyoksidit të sulfurit, dyoksidit të nitrogjenit, PM10, PM2,5, plumbit, benzinës dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit janë nën vlerat e kufirit përkatës specifikuar në Shtojcat XI dhe XIV, Shtetet Anëtare do të ruajnë nivelet e atyre ndotësve nën vlerat kufi dhe do të përpiqen të ruajnë cilësinë më të mirë të ajrit të mjedisit, të pajtueshëm me zhvillimin e qëndrueshëm.

Neni 13

Vlerat kufi dhe pragjet e alarmit për mbrojtjen e shëndetit publik

1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë, që në tërë zonat dhe grupimet e tyre, nivelet e dyoksidit të sulfurit, PM10, plumbit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit, të mos i kapërcejnë vlerat kufi parashtruar në Shtojcën XI.
Në lidhje me dyoksidin e nitrogjenit dhe benzinën, vlerat kufi specifikuar në Shtojcën XI, nuk mund të kapërcehen nga datat e specifikuara po aty.
Do të përlllogaritet përputhja me këto kërkesa sipas Shtojcës III.
Kufijtë e tolerancës parashtruar në Shtojcën XI, do të aplikohen në përputhje me nenin 22(3) dhe nenin 23(1).
2. Pragjet e alarmit për përqendrimit e dyoksidit të sulfurit dhe dyoksidit të nitrogjenit në ajrin e mjedisit, do të jenë ato që janë parashtruar në seksionin A të Shtojcës XII.

Neni 14

Nivelet kritike

1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë zbatimin e niveleve kritike specifikuar në Shtojcën XIII siç është përlogaritur në përputhje me Seksionin A të Shtojcës III.
2. Aty ku matjet e caktuara janë burimi i vetëm i informacionit për përlogaritjen e cilësisë së ajrit, numri i pikave të marrjes së kampioneve nuk do të jetë më pak sesa numri minimal specifikuar në Seksionin C të Shtojcës V. Atje ku ky informacion plotësohet nga matjet treguese dhe modelimi, numri minimal i pikave të marrjes së kampioneve mund të zvogëlohet më deri në 50 %, për sa kohë mund të përcaktohen përqendrimet e përlogaritura të ndotësve përkatës në përputhje me objektivat e cilësisë së të dhënave specifikuar në Seksionin A të Shtojcës I.

Neni 15

Synimi i zvogëlimit të ekspozimit ndaj PM_{2,5} në rang kombëtar për mbrojtjen e shëndetit publik

1. Shtetet Anëtare do të marrin tërë masat e domosdoshme pa përfshirë kostot e pajustificueshme për të zvogëluar ekspozimin ndaj PM_{2,5}, me qëllim arritjen e synimit kombëtar të zvogëlimit të ekspozimit, parashtruar në Seksionin B të Shtojcës XIV brenda vitit të specifikuar po aty.
2. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që treguesi mesatar i ekspozimit për vitin 2015 përcaktuar në përputhje me Seksionin A të Shtojcës XIV, të mos kapërcejë detyrimin e përqendrimit të ekspozimit parashtruar në Seksionin C të asaj Shtojce.
3. Treguesi mesatar i ekspozimit për PM_{2,5}, do të përlogaritet në përputhje me Seksionin A të Shtojcës XIV.
4. Secili Shtet Anëtar, në përputhje me Shtojcën III, do të sigurojë se shpërndarja dhe numri i pikave të marrjes së kampioneve në të cilat bazohet treguesi mesatar i ekspozimit për PM_{2,5} të reflektojë mjaftueshëm ekspozimin e përgjithshëm të popullsisë. Numri i pikave të marrjes së kampioneve nuk do të jetë më pak se ai i përcaktuar nga zbatimi i Seksionit B të Shtojcës V.

Neni 16

Vlera e synuar dhe vlera kufi e PM_{2,5} për mbrojtjen e shëndetit publik

1. Shtetet Anëtare do të marrin tërë masat e domosdoshme, pa përfshirë kostot e pajustificuara, për t'u siguruar që përqendrimet e PM_{2,5} në ajrin e mjedisit të mos kapërcejnë vlerën e synuar, parashtruar në Seksionin D të Shtojcës XIV që nga data e specifikuar po aty.
2. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që përqendrimet e PM_{2,5} në ajrin e mjedisit, të mos kapërcejnë vlerën kufi parashtruar në Seksionin E të Shtojcës XIV në tërë zonat dhe grupimet e tyre që nga data e specifikuar po aty. Do të përlogaritet përmbushja e këtyre kërkesave në përputhje me Shtojcën III.
3. Kufiri i tolerancës parashtruar në Seksionin E të Shtojcës XIV do të zbatohet në përputhje me nenin 23 pika (1).

Neni 17

Kërkesat në zona dhe grupime ku përqendrimet e ozonit kapërcejnë vlerat e synuara dhe objektivat afatgjata

1. Shtetet Anëtare do të marrin të gjitha masat e duhura për vlerat e synuara dhe objektivat afatgjata.
2. Për zonat dhe grupimet në të cilat kapërcehet vlera e synuar, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që, programi përgatitur sipas nenit 6 të Direktivës 2001/81/KE dhe nëse është e mundur, të jetë zbatuar një plan i cilësisë së ajrit për të arritur vlerat e synuara, me përjashtim të rastit kur kjo është e paarrtshme nëpërmjet masave, duke mos përfshirë kostot e pajustificueshme që nga data e specifikuar në Seksionin B të Shtojcës VII të kësaj Direktive.
3. Për zonat dhe grupimet në të cilat nivelet e ozonit në ajrin e mjedisit janë më të larta se objektivat afatgjata dhe, jo nën ose barabartë me vlerat e synuara, Shtetet Anëtare do të përgatisin dhe zbatojnë masa me kosto efektive me qëllim arritjen e objektivave afatgjata. Ato masa së paku do të jenë të pajtueshme me gjithë planet dhe programet për cilësinë e ajrit, përmendur në paragrafin 2.

Neni 18

Kërkesat në zona dhe grupime ku përqendrimet e ozonit përmbushin objektivat afatgjata

Në zonat dhe grupimet ku nivelet e ozonit përmbushin objektivat afatgjata, Shtetet Anëtare, për sa kohë faktorët të përfshijnë natyrën ndërkufitare të ndotjes së ozonit dhe kushtet meteorologjike të lejura, do të ruajnë këto nivele nën objektivat afatgjata dhe do të ruajnë, nën masa të përpjesëtuara, cilësinë më të mirë të ajrit të mjedisit në pajtim me zhvillimin e qëndrueshëm dhe nivelin e lartë të mbrojtjes së shëndetit publik dhe të mjedisit.

Neni 19

Masat e kërkuara në rast se kapërcehen pragjet e alarmit ose informacionit

Në vendet ku kapërcehet pragu i informacionit, specifikuar në Shtojcën XII apo çfarëdo pragu alarmi parashtruar po aty, Shtetet Anëtare do të marrin hapat e domosdoshëm për të informuar publikun nëpërmjet radios, televizionit, gazetave dhe internetit. Shtetet Anëtare do t'i dërgojnë, gjithashtu, informacion Komisionit në lidhje me nivelet e regjistruara dhe kohëzgjatjen e periudhave gjatë të cilave u kapërcye pragu i alarmit apo pragu i informacionit.

Neni 20

Kontributi nga burimet natyrore

1. Shtetet Anëtare do t'i transmetojnë Komisionit, për një vit të dhënë, lista të zonave dhe grupimeve ku kapërcimet e vlerave kufi për një ndotës të dhënë janë si rezultat i burimeve natyrore. Shtetet Anëtare do të sigurojnë informacion mbi përqendrimet,

burimet dhe provat, të cilat tregojnë se kapërcimet e niveleve janë si rezultat i burimeve natyrore.

2. Në vendet ku Komisioni është informuar për një kapërcim niveli si rezultat i burimeve natyrore në përputhje me paragrafin 1, ai kapërcim nuk do të konsiderohet i tillë për qëllim të kësaj Direktive.

3. Komisioni do të botojë, deri në datën 11 qershor 2010, udhëzimet për vërtetimin dhe zbritjen e kapërcimeve të niveleve si rezultat i burimeve natyrore.

Neni 21

Kapërcime si rezultat i hedhjes së rërës ose kripës në rrugë gjatë dimrit

1. Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë zona ose grupime brenda të cilave janë kapërcyer vlerat kufi për PM10 në ajrin e mjedisit si rezultat i rishpërndarjes së lëndës shkëputëse si pasojë e hedhjes së rërës ose kripës në rrugë gjatë dimrit.

2. Shtetet Anëtare do t'i dërgojnë lista Komisionit të çfarëdo zone apo grupimi të tillë së bashku me informacionin mbi përqendrimet dhe burimet e PM10 në ato zona.

3. Kur të informohet Komisioni në përputhje me nenin 27, Shtetet Anëtare duhet të japin provat e duhura për të demonstruar se kapërcimet e çfarëdo lloji, janë si rezultat i rishpërndarjes së lëndës shkëputëse dhe se janë marra masa të arsyeshme për të ulur përqendrimet.

4. Pa cenuar nenin 20, në raste zonash apo grupimesh të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë planin e cilësisë së ajrit paraqitur në nenin 23, vetëm për sa kohë kapërcimet e niveleve janë si rezultat i burimeve PM10 me përjashtim të hedhjes së rërës ose kripës në rrugë gjatë dimrit.

5. Brenda datës 11 qershor 2010, Komisioni do të botojë udhëzime për përcaktimin e kontributeve nga rishpërndarja e lëndës shkëputëse si pasojë e hedhjes së rërës ose kripës në rrugë gjatë dimrit.

Neni 22

Shtyrja e afateve të arritjes dhe përjashtimi nga detyrimet për të aplikuar vlera kufi të caktuara

1. Në zona ose grupime ku nuk mund të arrihet përputhja me vlerat kufi për dyoksidin e nitrogenit ose benzinës brenda afateve të specifikuara në Shtojcën XI, një Shtet Anëtar mund t'i shtyjë këto afate me një maksimum prej pesë vitesh për atë zonë ose grupim të caktuar, me kusht që të përcaktohet një plan për cilësinë e ajrit në përputhje me nenin 23 për zonën ose grupimin ku do të zbatohet shtyrja; një plan i tillë për cilësinë e ajrit do të plotësohet me informacionin e listuar në Seksionin B të Shtojcës XV lidhur me ndotësit e përfshirë dhe do të demonstrojë se si do të arrihet përputhja me vlerat kufi përpara afatit të ri.

2. Në rast se në një zonë ose grupim të caktuar nuk mund të arrihet përmbushja e vlerave kufi për PM10 siç është specifikuar në Shtojcën XI, për shkak të karakteristikave të shpërndarjes specifike për vendin, kushteve të pafavorshme klimatike ose kontributeve ndërkufitarë, një Shtet Anëtar do të përjashtohet nga detyrimet të zbatojë ato vlera kufi deri, më 11 qershor 2011, me kusht që të përmbushen kushtet e parashtruara në paragrafin 1 dhe që Vendi Anëtar të tregojë se

janë marrë të gjitha masat në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar për të respektuar afatet.

3. Në rast së një Shtet Anëtar zbaton paragrafët 1 dhe 2, do të sigurojë se vlera kufi për çdo ndotës nuk do të kapërcehet me më shumë se maksimumin e kufirit të tolerancës specifikuar në Shtojcën XI për secilin prej ndotësve të përfshirë.

4. Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin në rast kur, sipas pikëpamjes së tyre, paragrafët 1 dhe 2 janë të zbatueshme dhe do të komunikojnë planin e cilësisë së ajrit përmendur në paragrafin 1, përfshirë tërë informacionin përkatës të domosdoshëm për Komisionin që të përlllogarisë nëse janë plotësuar ose jo kushtet përkatëse. Komisioni, me përlllogaritjen e tij, do të marrë parasysh rezultatet e vlerësuara mbi cilësinë e ajrit të mjedisit në Shtetet Anëtare, në kohën e tashme dhe të ardhmen, që vijnë nga masat e marra nga Shtetet Anëtare, si edhe rezultatet e vlerësuara mbi cilësinë e ajrit të mjedisit që vijnë nga masat e sotme të Komunitetit dhe masat e planifikuara Komunitare për t'u propozuar nga Komisioni.

Në vendet ku Komisioni nuk ka ngritur kundërshtime brenda nëntë muajve pas marrjes së këtij njoftimi, kushtet përkatëse për zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2 do të vlerësohen si të përmbushura.

Nëse ngrihen kundërshtime, Komisioni mund t'u kërkojë Shteteve Anëtare të përshtatin ose sigurojnë plane të reja për cilësinë e ajrit.

KAPITULLI IV

PLANE

Neni 23

Plane për cilësinë e ajrit

1. Në rast kur në zona dhe grupime të caktuara nivelet e ndotësve në ajrin e mjedisit kalojnë çfarëdo vlere kufi ose vlerë të synuar, plus çfarëdo kufi përkatës tolerance në secilin rast, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të përcaktohen plane për cilësinë e ajrit për këto zona dhe grupime, në mënyrë që të arrijnë vlerën kufi ose vlerën e synuar përkatëse specifikuar në Shtojcat XI dhe XIV.

Në rast kapërcimi të këtyre vlerave kufi për të cilat ka skaduar afati i arritjes, planet e cilësisë së ajrit do të vendosin masa të përshtatshme, në mënyrë që periudha e kapërcimit të mbahet sa më e shkurtër të jetë e mundur. Planet e cilësisë së ajrit mundet gjithashtu të përfshijnë masa të veçanta me synim mbrojtjen e grupeve të ndjeshme të popullsisë, përfshirë fëmijët.

Ato plane të cilësisë së ajrit do të mishërojnë së paku informacionin e listuar në Seksionin A të Shtojcës XV dhe mund të përfshijnë masa në përputhje me nenin 24. Këto plane do t'i komunikohen Komisionit pa vonesë, por jo më vonë se dy vjet pas fundit të vitit kur u vu re kapërcimi i parë.

Aty ku duhen përgatitur ose zbatuar plane të cilësisë së ajrit në lidhje me disa ndotës, Shtetet Anëtare, aty ku është e mundur, do të përgatisin dhe zbatojnë plane të integruara për cilësinë e ajrit që të mbulojnë tërë ndotësit e përfshirë.

2. Shtetet Anëtare, deri në masë të mundshme, do të sigurojnë qëndrueshmëri me planet e tjera kërkuar sipas Direktivës 2001/80/KE, Direktivës 2001/81/KE ose Direktivës 2002/49/KE në mënyrë që të arrijnë objektivat përkatëse mjedisore.

Neni 24

Plane veprimi afatshkurtra

1. Në rast se në një zonë ose grupim të caktuar ekziston rreziku që nivelet e ndotësve do të kapërcejnë një ose më shumë prej pragjeve të alarmit specifikuar në Shtojcën XII, Shtetet Anëtare do të hartojnë plane aksion, për të treguar masat që do të merren me afat të shkurtër, në mënyrë që të zvogëlojnë rrezikun ose kohëzgjatjen e një kapërcimi të tillë. Në rastet kur ky rrezik vlen për një ose më shumë vlera kufi ose vlera të synuara specifikuar në Shtojcat VII, XI dhe XIV, Shtetet Anëtare, në rast se është e mundur, mund të hartojnë të tilla plane veprimi afatshkurtra. Megjithatë, në rastet kur ka rrezik të kapërcehet pragu i alarmit për ozonin specifikuar në Seksionin B të Shtojcës XII, Shtetet Anëtare do të hartojnë plane të tilla veprimi afatshkurtra vetëm kur sipas mendimit të tyre ka një mundësi të konsiderueshme, duke marrë parasysh kushtet ekonomike, meteorologjike dhe gjeografike kombëtare, për të zvogëluar rrezikun, kohëzgjatjen apo seriozitetin e një kapërcimit të tillë. Gjatë hartimit të një plani të tillë afatshkurtër veprimi, Shtetet Anëtare do të marrin parasysh Vendimin 2004/279/KE.

2. Planet afatshkurtra të veprimit përmendur në paragrafin 1, në varësi të rasteve, mund të sigurojnë masa efikase për të kontrolluar dhe atje ku është e domosdoshme, të ndalojnë aktivitetet që çojnë në rrezikun e vlerave kufi përkatëse dhe vlerave të synuara ose që çojnë në kapërcim të pragjeve të alarmit. Këto plane veprimi mund të përfshijnë masa në lidhje me trafikun e mjeteve me motor, kantier ndërtimi, anije në ankorim dhe përdorimin e bimëve ose produkteve industriale si dhe ngrohjen e shtëpive. Veprime të veçanta me synim mbrojtjen e grupeve të ndjeshme të popullsisë përfshirë fëmijët, mundet gjithashtu, të merren parasysh në kuadrin e këtyre planeve.

3. Kur Shtetet Anëtare të kenë hartuar një plan veprimi afatshkurtër, ata do ta bëjnë të mundshme për publikun dhe për organizata të përshtatshme si: organizata mjedisi, organizata konsumatori, organizata që përfaqësojnë interesat e grupeve të ndjeshme të popullsisë, njësi të tjera të kujdesit të shëndetit dhe federatat përkatëse industriale, si rezultate të hetimeve të tyre mbi mundësinë dhe përmbajtjen e planeve të veçanta afatshkurtra veprimi, ashtu edhe informacionin mbi zbatimin e këtyre planeve.

4. Për herë të parë përpara datës 11 qershor 2010 dhe në intervale të rregullta që nga ajo kohë, Komisioni do të publikojë shembuj të praktikave më të mira për hartimin e planeve afatshkurtra të veprimit, përfshirë shembuj të praktikave më të mira për mbrojtjen e grupeve të ndjeshme të popullsisë përfshirë fëmijët.

Neni 25

Ndotja ndërkufitare e ajrit

1. Në rastet kur kapërcehet pragu i alarmit, vlera kufi ose vlera e synuar, përfshirë dhe ndonjë kufi përkatës tolerance ose ndonjë objektivë afatgjatë si rezultat i transportit të konsiderueshëm ndërkufitar i ndotësve të ajrit ose si pararendës të tyre, Shtetet Anëtare, të përfshira, do të bashkëveprojnë ,dhe, atje ku është e mundur, do të hartojnë aktivitete të përbashkëta, si për shembull: përgatitjen e planeve të cilësisë së ajrit të koordinuara dhe të përbashkëta në përputhje me nenin 23, në mënyrë që të heqin këto kapërcime nëpërmjet zbatimit të masave të përshtatshme, por të përshkallëzuara.

2. Komisioni do të ftohet të paraqesë dhe të ndihmojë në çfarëdo bashkëpunimi përmendur në paragrafin 1, në rastet kur kjo është e mundur, duke marrë parasysh raportet e përcaktuara në përputhje me nenin 9 të Direktivës 2001/81/KE, ku do të shikojë nëse duhen marrë masa të mëtejshme në nivelin Komunitar, në mënyrë që të zvogëlojë lëshime ose çlirime pararendëse përgjegjës për ndotje ndërkuftare.

3. Shtetet Anëtare, nëse kjo është e përshtatshme në përputhje me nenin 24, do të përgatisin dhe zbatojnë plane veprimi të përbashkëta afatshkurtra që mbulojnë zona fqinje në Shtete të tjera Anëtare. Shtetet Anëtare do të sigurojnë se zonat fqinje në Shtetet e tjera Anëtare, të cilat kanë nxjerrë plane veprimi afatshkurtra, do të marrin gjithë informacionin e përshtatshëm.

4. Në vendet ku është kapërcyer pragu i informacionit ose pragu i alarmit, në zona ose grupime pranë kufijve kombëtare, do të sigurohet një informacion, sa më shpejt të jetë e mundur, për autoritetet kompetente në Shtetet Anëtare fqinje të përfshira. Ky informacion do të bëhet i disponueshëm për publikun gjithashtu.

5. Në hartimin e planeve siç është parashtruar në paragrafët 1 dhe 3 dhe në informimin e publikut siç përmendet në paragrafin 4, Shtetet Anëtare, atje ku është e mundur, do të përpiqen të ndjekin bashkëveprim me vendet e treta dhe në veçanti me vendet kandidate.

KAPITULLI V INFORMIMI DHE RAPORTIMI

Neni 26

Informimi publik

1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë se publiku si edhe organizatat e përshtatshme, si për shembull: organizatat e mjedisit, organizatat e përduruesve, organizata që përfaqësojnë interesat e grupeve të ndjeshme të popullsisë, njësi të tjera të kujdesit të shëndetit dhe federatat përkatëse industriale, janë të informuar, në masë të mjaftueshme dhe në kohën e duhur, për si më poshtë vijon:

- (a) cilësia e ajrit të mjedisit në përputhje me Shtojcën XVI;
- (b) çfarëdo vendim shtyrjeje në përputhje me nenin 22(1);
- (c) çfarëdo përjashtimi në përputhje me nenin 22(2);
- (d) plane të cilësisë së ajrit siç parashtrohet në nenin 22(1) dhe nenin 23 dhe programe të përmendura në nenin 17(2).

Informacioni do të bëhet i përdorshëm falas, nëpërmjet çfarëdo mjeti të arritshëm lehtë, përfshirë internetin ose metoda të tjera të përshtatshme telekomunikimi dhe do të marrë parasysh dispozitat e parashtruara në Direktivën 2007/2/KE.

2. Shtetet Anëtare do të bëjnë të përdorshëm për publikun raporte vjetore për gjithë ndotësit përfshirë në këtë Direktivë.

Ato raporte do të përmbledhin nivelet që: kapërcejnë vlerat kufi, vlerat e synuara, objektivat afatgjata, pragjet e informacionit dhe pragjet e alarmit, për periudhën mesatare përkatëse. Ky informacion do të bashkohet me një përmbledhje përlllogaritje të efekteve të atyre rasteve të kapërcimit. Raportet mund të përfshijnë, aty ku është e mundur, informacion dhe përlllogaritje të mëtejshme mbi mbrojtjen e pyjeve si edhe informacion mbi ndotës të tjerë për të cilët dispozitat e monitorimit janë specifikuar

në këtë Direktivë, si për shembull mes të tjerave: substanca paraprijëse ozoni të papërfshira në rregullore sipas listimit në Seksionin B të Shtojcës X.

3. Shtetet Anëtare do të informojnë publikun për autoritetin ose njësinë kompetente përcaktuar për detyrat e përmendura në nenin 3.

Neni 27

Transmetimi i informacionit dhe raportimit

1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të bëhet i përdorshëm informacioni mbi cilësinë e ajrit të mjedisit për Komisionin brenda skemës kohore të kërkuar, siç është përcaktuar nga masat zbatuese të përmendura në nenin 28 pika (2).

2. Në çfarëdo rasti, për qëllimin specifik të përlllogaritjes së pajtimit me vlerat kufi dhe nivelet kritike ,dhe arritjen e vlerave të synuara, informacion i tillë do të bëhet i përdorshëm për Komisionin, jo më vonë se nëntë muaj pas fundit të çdo viti dhe ky informacion do të përfshijë:

(a) ndryshimet e bëra në atë vit në listë dhe ndarjet e zonave dhe grupimeve të përcaktuara sipas nenit 4;

(b) lista e zonave dhe e grupimeve në të cilat nivelet e një ose më shumë ndotësve janë më të larta sesa vlerat kufi ,shtuar kufirin e tolerancës atje ku është e zbatueshme kjo ose më e lartë sesa vlerat e synuara ose nivelet kritike; dhe për këto zona dhe grupime:

(i) nivelet e përlllogaritura dhe, nëse është e mundur, datat dhe periudhat kur janë vënë re këto nivele;

(ii) nëse është e përshtatshme, një përlllogaritje e kontribuesve nga burimet natyrore dhe nga ridepozitimi i lëndës shkëputëse si pasojë e hedhjes së rërës ose kripës në rrugë në nivelet e përlllogaritura, siç i është deklaruar Komisionit sipas neneve 20 dhe 21.

3. Paragrafët 1 dhe 2 do të zbatohen për informacionin e mbledhur që nga fillimi i vitit të dytë kalendarik, pas hyrjes në fuqi të masave zbatuese përmendur në nenin 28 pika (2).

Neni 28

Masat zbatuese

1. Masat e përcaktuara për të ndryshuar elementet jo thelbësore të kësaj Direktive, përkatësisht Shtojcat I deri në VI, Shtojcat VIII deri X dhe Shtojcë XV, do të zbatohen në përputhje me procedurën rregulluese me kujdes të veçantë siç përmendet në nenin 29 pika (3).

Megjithatë, ndryshimet mund të mos kenë efektin e ndryshimit të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të secilës, si më poshtë:

(a) vlerat kufi, synimet e pakësuara të ekspozimit, nivelet kritike, vlerat e synuara, pragjet e informacionit dhe alarmit ose objektivat afatgjata specifikuar në Shtojcën VII dhe Shtojcat XI deri në XIV;

(b) datat për përmbushjen e parametrave të përmendur në pikën (a).

2. Në përputhje me procedurën rregulluese të përmendur në nenin 29(2), Komisioni do të vendosë informacionin shtesë që do të bëhet i përdorshëm nga Shtetet Anëtare,

në përputhje me nenin 27 si edhe skemat kohore në të cilat do të komunikohet ky informacion.

Komisioni do të njejtësojë, gjithashtu, mënyrat për standardizimin e raportimit të dhënave dhe të këmbimit të ndërsjellë të informacionit dhe të dhënave nga rrjete dhe stacione të veçanta që matin ndotjen e ajrit të mjedisit brenda Shteteve Anëtare, në përputhje me procedurën rregulluese të përmendur në nenin 29(2).

3. Komisioni do të hartojë udhëzime për marrëveshjet mbi ngritjen e stacioneve të përbashkëta matëse, siç përmendet në nenin 6(5).

4. Komisioni do të botojë udhëzimin mbi vertetimin e barasvlefshmërisë, përmendur në seksionin B të Shtojcës VI.

KAPITULLI VI

KOMITETI, DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 29

Komiteti

1. Komisioni do të ndihmohet nga një komitet: “Komiteti i Cilësisë së Ajrit të Ambientit”.

2. Në rastet që i referohen këtij paragrafi, do të zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

Periudha e caktuar në nenin 5 pika (6) të Vendimit 1999/468/KE do të vendoset në tre muaj.

3. Për rastet që i referohen këtij paragrafi, do të zbatohen nenet 5a(1) deri në (4) dhe neni 7 i Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8.

Neni 30

Gjobat

Shtetet Anëtare do të përcaktojnë rregullat për gjobat e zbatueshme për shkelje të dispozitave kombëtare, të përshtatura në përputhje me këtë Direktivë dhe do të marrin gjithë masat e domosdoshme për t’u siguruar se ato po zbatohen. Gjobat e përcaktuara duhet të jenë efikase, të përpjesëtueshme dhe me efekt mospërsëritje të shkeljes.

Neni 31

Shfuqizimi dhe dispozita kalimtare

1. Direktivat 96/62/KE, 1999/30/KE, 2000/69/KE dhe 2002/3/KE, do të shfuqizohen nga data 11 qershor 2010, pa cenuar detyrimet mbi Shtetet Anëtare që lidhen me kufijtë kohorë për zhvendosjen ose zbatimin e atyre Direktivave.

Megjithatë, nga data 11 qershor 2008, do të zbatohen si vijon:

(a) Në Direktivën 96/62/KE, paragrafi 1 i nenit 12 do të zëvendësohet si më poshtë vijon:

‘1. Rregullimet e detajuara për dërgimin e informacionit që do të sigurohet sipas nenit 11, do të përshtaten në përputhje me procedurën e përmendur në paragrafin 3’;

- (b) në Direktivën 1999/30/KE, neni 7 pika (7), shënimet në fund të faqes 1 në pikën I të Shtojcës VIII dhe pikën VI të Shtojcës IX do të fshihen;
- (c) në Direktivën 2000/69/KE, neni 5 pika (7) dhe pika III në Shtojcën VII do të fshihen ;
- (d) në Direktivën 2002/3/KE, neni 9 pika (5) dhe pika II e Shtojcën VIII do të fshihet.

2. Pavarësisht nga sa është përmendur në nënparagrafin e parë të paragrafit 1, nenet e mëposhtme do të mbeten në fuqi:

- (a) Neni 5 i Direktivës 96/62/KE deri në datën 31 dhjetor 2010;
- (b) Neni 11 pika (1) i Direktivës 96/62/KE dhe neni 10 pikat (1), (2) dhe (3) i Direktivës 2002/3/KE deri në fund të vitit të dytë kalendarik, pas hyrjes në fuqi të masave zbatuese të përmendura në nenin 28 pika (2) të kësaj Direktive;
- (c) Neni 9(3) dhe (4) i Direktivës 1999/30/EC deri, më 31 dhjetor 2009.

3. Referencat e bëra në Direktivat e shfuqizuara do të kuptohen si pjesë e kësaj Direktive dhe duhet të lexohen në përputhje me tabelën e ndërsjelltë në Shtojcën XVII.

4. Vendimi 97/101/KE do të shfuqizohet me vlefshmëri nga fundi i vitit të dytë kalendarik, pas hyrjes në fuqi të masave të zbatimit të përmendura në nenin 28(2) të kësaj Direktive.

Megjithatë, pasazhet e tretë, katërt dhe pestë të nenit 7 të Vendimit 97/101/KE do të fshihen me vlefshmëri nga data 11 qershor 2008.

Neni 32

Rishikimi

1. Në vitin 2013 Komisioni do të rishikojë dispozitat lidhur me PM_{2,5} dhe, aty ku është e përshtatshme edhe ndotës të tjerë, dhe do t'i paraqesë një propozim Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

Për sa i përket PM_{2,5}, rishikimi do të ndërmerret me pikësynimin e përcaktimit të detyrimit ligjor kombëtar për zvogëlimin e ekspozimit, në mënyrë që të zëvendësojë synimin kombëtar për zvogëlimin e ekspozimit dhe të rishikojë detyrimin e përqendrimit të ekspozimit parashtruar në nenin 15, duke marrë parasysh, midis të tjerash, elementet e poshtëshënuara:

- informacionet e fundit shkencore nga OBSH-ja dhe organizata të tjera të përshtatshme,
- situatat e cilësisë së ajrit dhe mundësitë e zvogëlimit në Shtetet Anëtare,
- përsëritjen e Direktivës 2001/81/KE
- progresin e bërë në zbatimin e masave Komunitare të zvogëlimit për ndotësit e ajrit.

2. Komisioni do të marrë parasysh mundësinë e përshtatjes së një vlere kufi më ambicioze për PM_{2,5}, do të rishikojë vlerën kufi treguese të fazës së dytë për PM_{2,5} dhe të mendojë për ta miratuar ose ndryshuar atë vlerë.

3. Si pjesë e rishikimit, Komisioni do të përgatisë gjithashtu një raport mbi përvojën dhe domosdoshmërinë e vëzhgimit të PM₁₀ dhe PM_{2,5}, duke marrë parasysh progresin teknik në teknikat automatike të matjes. Nëse është e vlefshme, do të propozohen metoda të reja reference për matjen e PM₁₀ dhe PM_{2,5}.

Neni 33

Përafrimi

1. Shtetet Anëtare do të sjellin në fuqi ligjet, rregullat dhe dispozitat administrative të domosdoshme për të vepruar në përputhje me këtë Direktivë, përpara datës 11 qershor 2010. Që nga kjo datë ata do t'i komunikojnë Komisionit tekstin e atyre masave. Kur Shtetet Anëtare do t'i përshtasin këto masa, ata do të mbajnë një referencë për këtë Direktivë ose do të shoqërohen nga një referencë e tillë, në rast botimi zyrtar të këtyre masave. Metodatat e bërjes së kësaj referencë do të caktohen nga Shtetet Anëtare.
2. Megjithatë, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të caktohen një numër i mjaftueshëm stacionesh matjeje me sfond urban për PM_{2,5} të domosdoshme për llogaritjen e Treguesit Mesatar të Ekspozimit, në përputhje me Seksionin B të Shtojcës V; kjo të bëhet jo më larg se 1 janar 2009, në mënyrë që të veprohet në përputhje me kornizën kohore dhe kushtet e treguara në Seksionin A të Shtojcës XIV.
3. Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjit kombëtar që ata kanë brenda fushës së mbuluar në këtë Direktivë.

Neni 34

Hyrja në fuqi

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi në ditën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 35

Të adresuarit

Kjo Direktivë u adresohet Shteteve Anëtare.
Hartuar në Strasburg, më datë 21 Maj 2008.

Për Parlamentin Evropian
Presidenti

H.-G. PÖTTERING

Për Këshillin
Presidenti

J. LENARČI

SHTOJCA 1
OBJEKTIVA TË CILËSISË SË TË DHËNAVE

A. Objektiva të cilësisë së të dhënave për përllogaritjen e cilësisë së ajrit të mjedisit

	Dyoksid sulfuri, dyoksid nitrogjeni dhe okside nitrogjeni ,dhe monoksid karboni	Benzinë	Lëndë shkëputëse (PM10/PM2.5) dhe plumb	Ozoni dhe NO dhe NO2
Masa fikse (1)				
Pasiguri	15%	25%	25%	15%
Të dhëna minimale	90%	90%	90%	90% gjatë verës 75% gjatë dimrit
Mbulim minimal kohor:				
- trafik urban	—	35%(2)	—	—
-vende industriale	—	90%	—	—
Masa treguese				
Pasiguri	25%	30%	50%	30%
Të dhëna minimale	90%	90%	90%	90%
Mbulim minimal kohor	14%(4)	14%(3)	14%(4)	>10% gjatë verës
Pasiguri modeli:				
Në bazë ore	50%	—	—	50%
Mesatare 8-orëshe	50%	—	—	50%
Mesatare ditore	50%	—	E papërcaktuar	—
Mesatare vjetore	30%	50%	50%	—
Përcaktim objektive				
Pasiguri	75%	100%	100%	75%

Pasiguria (e shprehur me nivel besueshmërie 95 %) e metodave të përllogaritjes, do të vlerësohet në përputhje me parimet e Udhëzuesit CEN për Shprehjen Pasigurisë në Vlerësim (ENV 13005-1999), metodologjia e ISO 5725:1994 dhe udhëzimet e siguruar në raportin e CEN “Cilësia e Ajrit — Metoda për Matjen e Pasigurisë për metodat Referencë të Matjes për Ajrin e Mjedisit’ (CR 14377:2002E). Përqindjet për pasigurinë në tabelën e mësipërme janë dhënë për matje të veçuara në mesatare mbi periudhën e marrë parasysh nga vlera kufi (ose vlerës së synuar në rastin e ozonit), për një interval besueshmërie 95 %. Pasiguria për masat fikse do të interpretohet si e zbatueshme në rajonin e vlerës së përshtatshme kufi (ose vlerës së synuar në rastin e ozonit).

Pasiguria për modelim është përkufizuar si devijimi maksimal i niveleve të matura e të llogaritura për 90 % të pikave të veçuara të vëzhgimit, gjatë periudhës së shqyrtuar, me vlerën kufi (ose vlerën e synuar në rastin e ozonit), pa marrë parasysh kohën e

ngjarjeve. Pasiguria për modelimin do të interpretohet si e zbatueshme në rajonin e vlerës me kufi të përshtatshëm (ose vlerës së synuar në rastin e ozonit). Matjet fikse që duhet të zgjidhen për krahasim me rezultatet e modelimit, do të jenë përfaqësuese të shkallës së mbuluar nga modeli.

Pasiguria për vlerësimin e objektives, përkufizohet si lejimi më i madh i niveleve të përqendrimit të matura dhe të llogaritura, gjatë periudhës së shqyrtuar, me vlerën kufi (ose vlerën e synuar në rastin e ozonit), pa marrë parasysh kohën e ngjarjeve.

Kërkesat, për marrjen e të dhënave më të vogla dhe mbulimin kohor, nuk përfshijnë humbjen e të dhënave ri rezultat i përgatitjes së vazhdueshme apo mirëmbajtjes normale të instrumenteve.

B. Rezultatet e përllogaritjes së cilësisë së ajrit

Për zonat dhe grupimet brenda të cilëve përdoren burime të tjera ,përveç matjes, do të hartohet informacioni i poshtëshënuar, për të plotësuar informacionin nga matjet ose si mënyra e vetme e përllogaritjes së cilësisë së ajrit:

- përshkrim i aktiviteteve të kryera për përllogaritje,
- metodat specifike të përdorura me referenca për përshkrimin e metodës,
- burimet e të dhënave dhe informacioni,
- përshkrimi i rezultateve përfshirë pasiguritë dhe ,në veçanti, shtrirjen e çdo zone, ose, nëse është e vlefshme, gjatësinë e rrugës brenda zonës, ose grupimit mbi të cilat përqendrimet kapërcejnë çfarëdo vlere kufi, vlerë të synuar ose objektivë afatgjate duke shtuar kufirin e tolerancës, nëse kjo është e zbatueshme, dhe të çdo zone brenda të cilës përqendrimet kapërcejnë pragun e lartë të përllogaritjes ose pragun e ulët të përllogaritjes,
- popullsia që shihet si e ekspozuar ndaj niveleve të teprisë, të çfarëdo vlere kufi, për mbrojtjen e shëndetit publik.

C. Sigurimi i cilësisë për përllogaritjen e cilësisë së ajrit të mjedisit, konfirmim i të dhënave

1. Për të siguruar saktësi në matje dhe pajtueshmëri me objektivat e cilësisë së të dhënave parashtruar në Seksionin A, autoritetet dhe njësitë e përshtatshme të përcaktuara në përputhje me nenin 3 do të sigurojnë si më poshtë:

- se gjithë masat e ndërmarra në lidhje me përllogaritjen e cilësisë së ajrit të mjedisit në përputhje me nenet 6 dhe 9, janë të kalueshme në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Seksionin 5.6.2.2 të ISO/IEC 17025:2005,
- se rrjetet e veprimtimit të institucioneve dhe stacionet e veçuara të kenë një siguri cilësie të përcaktuar dhe sistem për kontrollin e cilësisë, që siguron mirëmbajtje të vazhdueshme në sigurimin e saktësisë të mjeteve matëse,
- se është përcaktuar një proces kontroll cilësie a sigurim cilësie, për procesin e mbledhjes së të dhënave dhe raportimin në mënyrë që institucionet e zgjedhura për këtë detyrë të marrin pjesë aktive në programet mbarë Komunitare të sigurimit të cilësisë,
- se laboratorët kombëtarë, kur emerohen nga autoriteti ose njësi e përshtatshme kompetente caktuar në përputhje me nenin 3, që marrin pjesë në ndërkrasime mbarë komunitare që mbulojnë ndotës të parashikuar në këtë Direktivë, të jenë të pranuar sipas EN/ISO 17025 deri në vitin 2010 për metodat e referencës të përmendura në Shtojcën VI. Këto laboratorë do të përfshihen në bashkërendimin në territorin e Shteteve Anëtare të programeve të sigurimit të cilësisë mbarë komunitare, që do të

organizohen nga Komisioni dhe do të bashkërendojnë gjithashtu, në nivel kombëtar, realizimin e përshtatshëm të metodave të referencës dhe vertetimin e barasvlefshmërisë së metodave jo për referencë.

2. Të gjithë të dhënat e raportuara nën nenin 27 do të përcaktohen si të vlefshme, me përjashtim të të dhënave të shënuara si të përkohshme.

(1) Shtetet Anëtare mund të zbatojnë masa të rastësishme në vend të masave të vazhdueshme për benzinën, plumbin dhe lëndën shkëputëse nëse mund t'i tregojnë Komisionit pasiguri, përfshirë dhe pasigurinë për shkak të kampioneve të rastësishme, që përmbushin objektivat e cilësisë në 25% dhe se mbulimi kohor është akoma më i madh sesa mbulimi kohor minimal për masat treguese. Kampionet e rastësishme duhet të shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme gjatë vitit për të shmangur devijimet në rezultat. Pasiguria si rezultat i kampioneve të rastësishme, mund të përcaktohet nga procedura e parashtuar në ISO 11222 (2002) "Cilësia e Ajrit — Përcaktimi i Pasigurisë së Mesatares së Kohës për Matjet e Cilësisë së Ajrit". Nëse përdoren matjet e rastësishme për të përlogaritur kërkesat e vlerës së kufirit të PM10, duhet të vlerësohet përqindja 90,4 (të jetë më e ulët se ose e barabartë me 50 µg/m³) në vend të numrit të kapërcimit të vlerave, gjë që ndikohet shumë nga mbulimi i të dhënave.

(2) Shpërndarë gjatë vitit për të përfaqësuar kushtet e ndryshme për klimën dhe trafikun.

(3) Matje në një ditë për çdo javë në mënyrë të papërcaktuar, shpërndarë njëtrajtshëm gjatë vitit, ose tetë javë shpërndarë njëtrajtshëm gjatë vitit.

(4) Një matje në javë në mënyrë të papërcaktuar, shpërndarë njëtrajtshëm gjatë vitit, ose tetë javë shpërndarë njëtrajtshëm gjatë vitit.

SHTOJCA II

Përcaktimi i kërkesave për përlogaritjen e përqendrimeve të dyoksidit të sulfurit, dyoksidit të nitrogjenit dhe oksideve të nitrogjenit, lëndës shkëputëse (PM10 dhe PM2,5), plumbit, benzinës, dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit brenda një zone apo grupimi

A. Pragjet e përlogaritjes së lartë dhe të ulët

Do të zbatohen pragjet e mëposhtme të përlogaritjes së lartë dhe të ulët:

1. Dyoksid sulfurit

	Mbrojtja e shëndetit	Mbrojtja e bimësisë
Pragu i përlogaritjes së lartë	60 % e vlerës kufi 24-orë (75 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 3 herë në çfarëdo viti kalendarik)	60 % e nivelit kritik në dimër (12 µg/m ³)
Pragu i përlogaritjes së ulët	40 % e vlerës kufi 24-orë (50 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se tre herë në çfarëdo viti kalendarik)	40 % e nivelit kritik në dimër (8 µg/m ³)

2. Dyoksid Nitrogjeni dhe okside të nitrogjenit

	Vlera kufi në orë për mbrojtjen e shëndetit publik (NO ₂)	Kufiri vjetor për mbrojtjen e shëndetit publik (NO ₂)	Niveli kritik vjetor për mbrojtjen e bimësisë dhe ekosistemeve natyrore (NO _x)
Pragu i përlllogaritjes së lartë	i së 70 % e vlerës kufi (140 µg/m ³ , të mos kapërcehet me më shumë se 18 herë në çfarëdo viti kalendarik)	80 % e vlerës kufi (32 µg/m ³)	80 % e nivelit kritik (24 µg/m ³)
Pragu i përlllogaritjes së ulët	i së 50 % e vlerës kufi (100 µg/m ³ , të mos kapërcehet me më shumë se 18 herë në çfarëdo viti kalendarik)	65 % e vlerës kufi (26 µg/m ³)	65 % e nivelit kritik (19,5 µg/m ³)

3. Lëndë shkëputëse (PM₁₀/PM_{2,5})

Mesatare 24-orëshe PM ₁₀	Mesatare vjetore PM ₁₀	Mesatare vjetore PM _{2,5} (1)
70 % e vlerës kufi (35 µg/m ³ , të mos kapërcehet me më shumë se 35 herë në çfarëdo viti kalendarik)	70 % e vlerës kufi (28 µg/m ³)	70 % e vlerës kufi (17 µg/m ³)
50 % e vlerës kufi (25 µg/m ³ , të mos kapërcehet me më shumë se 35 herë në çfarëdo viti kalendarik)	50 % e vlerës kufi (20 µg/m ³)	50 % e vlerës kufi (12 µg/m ³)

(1) Pragu i përlllogaritjes së lartë dhe pragu i përlllogaritjes së ulët për PM_{2,5} nuk janë të vlefshme për matjet për të përlllogaritur pajtueshmëri me synimin e zvogëlimit të ekspozimit PM_{2,5} për mbrojtjen e shëndetit publik.

4. Plumbi

	Mesatarja vjetore
Pragu i përlllogaritjes së lartë	70 % e vlerës kufi (0,35 µg/m ³)
Pragu i përlllogaritjes së ulët	50 % e vlerës kufi (0,25 µg/m ³)

5. Benzina

	Mesatarja vjetore
Pragu i përlllogaritjes së lartë	70 % e vlerës kufi (3,5 µg/m ³)
Pragu i përlllogaritjes së ulët	40 % e vlerës kufi (2 µg/m ³)

6. Monoksidi i karbonit

	Mesatarja 8 -orë
Pragu i përlogaritjes së lartë	70 % e vlerës kufi (7 mg/m ³)
Pragu i përlogaritjes së ulët	50 % e vlerës kufi (5 mg/m ³)

B. Përcaktimi i kapërcimit të pragjeve të përlogaritjes së lartë dhe të ulët

Kapërcimet e pragjeve të përlogaritjes së lartë dhe të ulët do të përcaktohen në bazë të përqendrimeve gjatë pesë viteve të mëparshme atje ku ka të dhëna të mjaftueshme. Pragu i përlogaritjes do të vlerësohet si i kapërcyer nëse është kapërcyer gjatë, së paku ,tre viteve të shkëputura të atyre pesë viteve.

Në rastet kur ka të dhëna të dipsonueshme ,për më pak se pesë vjet, Shtetet Anëtare mund të ndërthurin fushata matjeje me kohëzgjatje të shkurtër gjatë periudhës së vitit, dhe në vendndodhje ,që kanë prirje të jenë tipike të niveleve më të larta të ndotjes me rezultate të marra nga informacione nga inventarë çlirimi dhe modelimi, për të përcaktuar rastet e kapërcimit të pragjeve të përlogaritjes së lartë dhe të ulët.

SHTOJCA III

Përlogaritja e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe vendndodhja e pikave të marrjes së kampioneve për matjen e dyoksidit të sulfurit, dyoksidit të nitrogjenit dhe oksideve të nitrogjenit, lëndë shkëputëse (PM10 dhe PM2,5), plumb, benzinë dhe monoksid karboni në ajrin e mjedisit

A. Të përgjithshme

Cilësia e ajrit të mjedisit do të përlogaritet në gjithë zonat dhe grupimet në përputhje me kriteret e mëposhtme:

1. Cilësia e ajrit të mjedisit do të përlogaritet në të gjitha vendndodhjet me përjashtim të atyre të listuara në paragrafin 2, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Seksionet B dhe C për vendndodhjen e pikave të marrjes së kampioneve për matjet e ngulitura. Parimet e përcaktuara nga Seksionet B dhe C do të vlejnjë, gjithashtu, për sa kohë janë të vlefshme në njëjtësimin e vendndodhjeve specifike në të cilat përqendrimi i ndotësve përkatës është përcaktuar ku cilësia e ajrit të mjedisit matet nga masat treguese ose modelimit.

2. Nuk do të përlogaritet përmbushja e vlerave kufi, drejtuar mbrojtjes së shëndetit të njeriut, në vendndodhjet e mëposhtme:

- (a) çfarëdo vendndodhje brenda zonave, ku anëtarë të publikut nuk kanë të drejtë hyrje dhe nuk është një vendndodhje e përcaktuar;
- (b) në përputhje me nenin (1), në ndërtesa fabrikash ose në instalime industriale ku zbatohen tërë dispozitat përkatëse në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë;
- (c) në korsinë e rrugëve dhe në rezervatet qendrore të rrugëve me përjashtim, ku ka hyrje kalimtarësh për në rezervatin kryesor.

B. Ngritja në shkallë makro e pikave të marrjes së kampioneve

1. Mbrojtja e shëndetit publik

(a) Pikat e marrjes së kampioneve drejtuar mbrojtjes së shëndetit publik, do të ngrihen në mënyrë të tillë që të sigurojnë të dhëna, si më poshtë:

— sipërfaqet brenda zonave dhe grupimeve ku shfaqen përqendrimet më të larta, ndaj të cilave popllsia, janë të prirura të jenë të ekspozuara drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti, për një periudhë domethënëse, në lidhje me periudhën mesatare të vlerës (vlerave) kufi,

— nivelet në sipërfaqe të tjera brenda zonave dhe grupimeve të cilat janë përfaqësuese të ekspozimit të popullsisë së përgjithshme;

(b) Pikat e marrjes së kampioneve në përgjithësi do të ngrihen në mënyrë të tillë, që të shmangin matjen e mikro-mjediseve shumë të vogla në afërsi të tyre, që do të thotë se një pikë e marrjes së kampioneve të ngrihet, në mënyrë të tillë, që ajri i marrë si kampion të jetë përfaqësues i cilësisë së ajrit për një segment rruge jo më pak se 100 m gjatësi në vende me trafik dhe së paku 250 m × 250 m në zonat industriale, atje ku është e mundur;

(c) vendndodhjet me sfond urban do të jenë të tilla që niveli i ndotjes të jete ndikuar nga kontributi i shkrirë nga të gjitha burimet në drejtimin kundër erës të stacionit. per Redin Niveli i ndotjes nuk duhet të mbizotërohet nga një burim i vetëm në rast se një situatë e tillë nuk është tipike për një sipërfaqe më të madhe urbane. Këto pika të marrjes së kampioneve, si rregull i përgjithshëm, do të jenë përfaqësuese për disa kilometra katrorë;

(d) atje ku objektivi është të përlllogariten nivele me sfond rural, pika e marrjes së kampioneve nuk do të ndikohet nga grupimet ose zonat industriale në afërsi të saj, d.m.th. zona më afër se pesë kilometra;

(e) në rastet kur do të përlllogariten kontribues nga burime industriale do të instalohet, së paku, një pikë e marrjes së kampioneve në drejtim nga fryn era, në lidhje me burimin, në zonën më të afërt të banuar. Kur nuk dihet natyra e përqendrimit, do të ngrihet një pikë shtesë për marrjen e kampioneve brenda drejtimit kryesor të erës.

(f) Pikat e marrjes së kampioneve, ku është e mundur, do të jenë përfaqësuese të vendndodhjeve të ngjashme në afërsi të tyre;

(g) Do të merret parasysh nevoja për të vendosur pikat e marrjes së kampioneve në ishujt ku kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit publik.

2. Mbrojtja e bimësisë dhe ekosistemeve natyrore

Pikat e marrjes së kampioneve, me synim mbrojtjen e bimësisë dhe të ekosistemeve natyrore, do të ngrihen në më shumë se 20 km larg grupimeve ose në më shumë se 5 km larg zonave të tjera me shumë ndërtime, përqendrimeve industriale ose rrugëve automobilistike apo rrugëve kryesore me sasi trafiku në më shumë se 50 mijë automjete në ditë, që do të thotë se një pikë për marrjen e kampioneve duhet të vendoset në mënyrë të tillë, që ajri i marrë për kampion të jetë përfaqësues i cilësisë së ajrit në një zonë rrethuese prej së paku 1000 km². Një Shtet Anëtar mund të vendosë që pikë e marrjes së kampioneve të ngrihet në një distancë më të vogël ose të jetë përfaqësuese e cilësisë së ajrit në një zonë me përhapje më të vogël, duke marrë parasysh kushtet gjeografike ose mundësitë për të mbrojtur zona veçanërisht të prekshme.

Do të merret parasysh nevoja për të përlllogaritur cilësinë e ajrit në ishuj.

C. Ngritja në shkallën mikro e pikave të marrjes së kampioneve

Nëse është e praktikueshme, do të zbatohen si vijon:

- rrjedha rreth provëzës marrëse të kampionit do të jetë e pakufizuar (e lirë në një hark prej së paku 270°), pa ndonjë bllokim që ndikon rrjedhën e ajrit në afërsi të matësit (normalisht disa metër larg ndërtesave, ballkoneve, pemëve dhe pengesave të tjera

dhe së paku 0,5 m nga ndërtesa më e afërt me rastin e pikave stë marrjes së kampioneve përfaqësuese të cilësisë së ajrit në linjën e ndërtesave);

- në përgjithësi, pika e marrjes së kampioneve do të jetë midis 1,5 m (zona e frymëmarrjes) dhe 4 m mbi tokë. Pozicionet më të larta (deri në 8 m) mund të nevojiten në disa rrethana. Vendosjet më të larta mund të jenë, gjithashtu, të përshtatshme nëse stacioni është përfaqësues i një sipërfaqeje të madhe;

- provëza marrëse nuk do të vendoset në afërsi të menjëhershme të burimet, në mënyrë që të shmanget marrja e drejtpërdrejtë e ndotjeve të çliruara të papërziera me ajrin e mjedisit,

- pika nxjerrëse e tymrave do të vendoset në mënyrë të tillë që të shmanget riqarkullimi i ajrit të ndotur në marrësin e kampionit,

- për gjithë ndotësit, provëzat e kampioneve me orientim trafiku do të jenë së paku 25 m nga fillimi i kryqëzimeve kryesore dhe jo më shumë se 10 m nga fillimi i pjesës së ngritur.

Mund të merren gjithashtu parasysh faktorët e mëposhtëm:

- burimet ndërhyrëse,

- siguria,

- arritshmëria,

- vlefshmëria e energjisë elektrike dhe e komunikimit telefonik,

- dukshmëria e vendit në lidhje me rrethinat,

- siguria e publikut dhe e vepruesve,

- dëshira për vendosjen e përbashkët të pikave të marrjes së kampioneve për ndotës të ndryshëm,

- kërkesat e planifikimit

D. Dokumentimi dhe rishikimi i zgjedhjes së vendit

Procedurat e zgjedhjes së vendit do të jenë të dokumentuara tërësisht në fazën e klasifikimit me mjete të tilla si: fotografi me orientim gjeografik të sipërfaqes rrethuese dhe me një hartë të detajuar. Vendet do të rishikohen në intervale të rregullta me dokumentacion të përsëritur për të siguruar se kriteret e përzgjedhjes mbeten të vlefshme me kalimin e kohës.

SHTOJCË IV

MATJETE NË VENDNDODHJE ME SFOND RURAL PAVARËSISHT NGA PËRQËNDRIMI

A. Objektivat

Objektivat kryesore të matjeve të tjera janë për të siguruar që informacioni i përshtatshëm të bëhet i arritshëm mbi nivelet në sfond. Ky informacion është i domosdoshëm për të gjykuar nivelet e ngritura me sipërfaqe të mëdha ndotjeje (si për shembull: sfond urban, vendndodhje industriale, vendndodhje me trafik), për të përlllogaritur kontributin e mundshëm nga transporti, për së largu, të ndotësve të ajrit, për të mbështetur analizën e përpjestimit të burimeve dhe për të kuptuar ndotësit

specifikë, si p.sh: lëndët shkëputëse. Kjo është gjithashtu e domosdoshme për shtimin e përdorimit të modelimit edhe në sipërfaqet urbane.

B. Substancat

Matjet e PM_{2,5} duhet të përfshijnë së paku përqendrimin masiv të plotë dhe përqendrime të përbërjeve të përshtatshme, për të karakterizuar përbërjen kimike. Së paku duhet të përfshihet lista e specieve kimike e dhënë më poshtë.

SO ₄ ²⁻	Na ⁺	NH ₄ ⁺	Ca ²⁺	Karbon natyror (EC)
NO ₃ ⁻	K ⁺	Cl ⁻	Mg ²⁺	Karbon organik (OC)

C. Vendosija

Duhet marrë masa, në veçanti, në sipërfaqe me sfond rural, në përputhje me pjesët A, B dhe C të Shtojcës III.

SHTOJCA V

Kriteret për përcaktimin e numrit minimal të pikave të marrjes së kampioneve për matjet fikse të përqendrimeve të dyoksidit të sulfurit, dyoksidit të nitrogjenit dhe oksideve të nitrogjenit, lëndës së shkëputur (PM₁₀, PM_{2,5}), plumbit, benzinës dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit.

A. Numri minimal i pikave të marrjes së kampioneve, për matje fikse, për të përlllogaritur përmbushjen e vlerave kufi në mbrojtjen e shëndetit publik dhe pragjeve të alarmit në zona dhe grupime ku matjet fikse janë i vetmi burim i informacionit

1. Shpërndarja e burimeve

Nëse përqendrime maksimale kapërcejnë pragun e përlllogaritjes së lartë (1), nëse përqendrime maksimale janë midis pragjeve të përlllogaritjes së lartë dhe të ulët

Popullsia e grupimit ose zonës (mijëra)	Ndotës me përjashtim të PM	me të	PM (2) (shuma e PM ₁₀ dhe PM _{2,5})	Ndotës me përjashtim të PM	me të	PM (2) (shuma e PM ₁₀ dhe PM _{2,5})
0-249	1		2	1		1
250-499	2		3	1		2
500-749	2		3	1		2
750-999	3		4	1		2
1 000-1 499	4		6	2		3
1 500-1 999	5		7	2		3
2 000-2 749	6		8	3		4
2 750-3 749	7		10	3		4
3 750-4 749	8		11	3		6

4 750-5 999	9	13	4	6
≥ 6 000	10	15	4	7

(1) Për dyoksidin e nitrogjenit, lëndën e shkëputur, benzinën dhe monoksidin e karbonit: të përfshijë së paku një stacion monitorimi më sfond urban dhe një stacion me orientim trafikun, me kusht që kjo të mos rrisë numrin e pikave të marrjes së kampioneve. Për këta ndotës, numri total i stacioneve me sfond urban dhe numri total i stacioneve me orientim trafikun në një Shtet Anëtar kërkuar sipas Seksionit A(1), nuk do të ndryshojë me më shumë se një faktor prej 2. pikat e marrjes së kampioneve me kapërcim të vlerës kufi për PM10 brenda tre viteve të fundit do të ruhen, nëse nuk është e domosdoshme të bëhet një rishtrirje si rezultat i rrethanave, brenda zhvillimit hapësinor të veçantë .

(2) Në vendet ku PM2,5 dhe PM10 maten në përputhje me nenin 8 në të njëjtin stacion vëzhgimi, këto do të llogariten si dy pika marrje kampionesh të veçuara. Numri total i pikave të marrjes së kampioneve për PM2,5 dhe PM10 në një Shtet Anëtar kërkuar sipas Seksionit A(1) nuk do të ndryshojnë me më shumë se një faktor prej 2, dhe numri i pikave të marrjes së kampioneve të PM2,5 në sfondin urban të grupimeve dhe sipërfaqeve urbane do të përmbushin kërkesat nënë Seksionin B të Shtojcës V.

2. Burimet e Pikave të marrjes së kampioneve

Për përlllogaritjen e ndotjes në afërsi të burimeve të pikave, numri i pikave të marrjes së kampioneve për matjet fikse do të llogaritet duke marrë parasysh dendësinë e çlirimit të ndotësve, forma e shpërndarjes së ndotjes të ajrit të mjedisit dhe ekspozimi i mundshëm i popullsisë.

B. Numri minimal i pikave të marrjes së kampioneve për matjet fikse për të përlllogaritur përmbushjen e synimit të zvogëlimit të ekspozimit të PM2,5 për mbrojtjen e shëndetit publik.

Për këtë qëllim do të përdoret një pikë marrje kampionesh për një milion banorë e mbledhur në grupime dhe sipërfaqe të tjera urbane më shumë se 100 000 banorë. Ato pika mund të korrespondojnë me pikat e marrjes së kampioneve sipas Seksionit A.

C. Numri minimal i pikave të marrjes së kampioneve për matje fikse për të përlllogaritur përmbushjen e niveleve kritike për mbrojtjen e bimësisë në zona të tjera përveç grupimeve.

Nëse përqendrimet maksimale kapërcejnë pragun e përlllogaritjes së lartë

Nëse përqendrimet maksimale janë midis pragjeve të përlllogaritjes së lartë dhe të ulët

1 stacion në çdo 20 000 km²

1 stacion çdo 40 000 km²

Në zona ishujsh numri i pikave të marrjes së kampioneve për matje fikse duhet të llogaritet duke marrë parasysh format e shpërndarjes së ndotjes së ajrit të mjedisit dhe ekspozimet e mundshme të bimësisë.

SHTOJCA VI

Metodat e referencës për përlllogaritjen e përqendrimeve të dyoksidit të sulfurit, dyoksidit të nitrogjenit dhe oksideve të nitrogjenit, lëndës së shkëputur (PM10 dhe PM2,5), plumbit, benzinës, monoksidit të karbonit dhe ozonit

A. Metoda referencë për matje

1. Metodë referencë për matjen e dyoksidit të sulfurit

Metoda referencë për matjen e dyoksidit të sulfurit është ajo që përshkruhet në EN 14212:2005 “Cilësia e ajrit të mjedisit — Metodë standarde për matjen e përqendrimit të dyoksidit të sulfurit me fluoreshencë ultravjollcë”.

2. Metoda referencë për matjen e dyoksidit të nitrogjenit dhe oksideve të nitrogjenit

Metoda referencë për matjen e dyoksidit të nitrogjenit dhe oksideve të nitrogjenit është ajo që përshkruhet në EN 14211:2005 “Cilësia e ajrit të mjedisit — Metodë standarde për matjen e përqendrimit të dyoksidit të nitrogjenit dhe monoksidit të nitrogjenit me kemilumineshencë”.

3. Metoda referencë për marrjen e kampioneve dhe matjen e plumbit

Metoda referencë për marrjen e kampioneve dhe matjen e plumbit është ajo që përshkruhet në Seksionin A(4) të kësaj Shtojce. Metoda e referencës për matjen e plumbit është ajo që është përshkruar në EN 14902:2005 “Metoda standarde për matjen e Pb/Cd/As/Ni në fraksionin PM10 të lëndës së shkëputur të bllokuar”.

4. Metoda e referencës për marrjen e kampioneve dhe matjen e PM10

Metoda e referencës për marrjen e kampioneve dhe matjen e PM10 është ajo që është përshkruar në EN 12341:1999 “Cilësia e ajrit — Përcaktimi i fraksionit PM10 të lëndës së shkëputur të bllokuar — Metoda referencë dhe procedura e testeve në fushë për të treguara barasvlefshmërinë e referencës për metodat e matjes”.

5. Metoda e referencës për marrjen e kampioneve dhe matjen e PM2,5

Metoda e referencës për marrjen e kampioneve dhe matjen e PM2,5 është ajo e përshkruar në EN 14907:2005 “Metodë matjeje gravimetrike standarde për përcaktimin e fraksionin masë PM2,5 të lëndës së shkëputur të bllokuar”.

6. Metoda e referencës për marrjen e kampioneve dhe matjen e benzinës

Metoda referencë për matjen e benzinës është ajo e përshkruar në EN 14662:2005, pjesët 1, 2 dhe 3 “Cilësia e ajrit të mjedisit — Metoda standarde për matjen e përqendrimeve të benzinës”.

7. Metoda e referencës për matjen e monoksidit të karbonit

Metoda e referencës për matjen e monoksidit të karbonit është ajo e përshkruar në EN 14626:2005 “Cilësia e ajrit të mjedisit — Metoda standarde për matjen e përqendrimit të monoksidit të karbonit me spektroskopin infra të kuqe jo shpërndarëse”.

8. Metoda e referencës për matjen e ozonit

Metoda e referencës për matjen e ozonit është ajo e përshkruar në EN 14625:2005 “Cilësia e ajrit të mjedisit — Metoda standarde për matjen e përqendrimit të ozonit me fotometri ultravjollcë”.

B. Demonstrimi i njëvlefshmërisë

1. Një Shtet Anëtar mund të përdorë dhe një metodë tjetër për të cilët mund të tregojë se jep rezultate të barabarta me ato të cilësdo metode të përmendur në Seksionin A ose, në rastin e lëndës së shkëputur, çfarëdo metode tjetër për të cilën Shteti Anëtar i

përfshirë mund të tregojë se shfaq lidhje të qëndrueshme me metodën e referencës. Në atë rast rezultatet e arritura nga ajo metodë duhet të korrigjohen për të nxjerrë rezultate të barasvlershme me ato që do të arriheshin nëse do të përdorej metoda e referencës.

2. Komisioni mund të kërkojë që Shteti Anëtar të përgatisë dhe dorëzojë një raport për tregimin e barasvlefshmërisë në përputhje me paragrafin 1.

3. Kur bëhet përlllogaritja e pranueshmërisë së raportit të përmendur në paragrafin 2, Komisioni do t'i referohet udhëzimit të tij mbi tregimin e barasvlefshmërisë (do të botohet). Në rastet kur Shtetet Anëtare kanë përdorur metoda të përkohshme për të dhënë me përafërsi barasvlefshmërinë, kjo e fundit do të konfirmohet dhe/ose ndryshohet sipas udhëzimit të Komisionit.

4. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë se kur kjo është e vlefshme, korrigjimi të bëhet me efekt prapaveprues për të dhëna matjeje të së kaluarës, me qëllim që të arrihet një krahasueshmëri më e mirë të dhënash.

C. Standardizimi

Për ndotës në formë gazi duhet të standardizohet vëllimi në një temperaturë prej 293 K dhe trysni atmosferike prej 101,3 kPa. Për lëndën shkëputëse dhe substancat për analizë në lëndën shkëputëse (p.sh. plumbi) vëllimi i kampionit i referohet kushteve të mjedisit lidhur me temperaturën dhe trysninë atmosferike në datën e matjes.

D. Prezantimi i pajisjeve të reja

Gjithë pajisjet e reja të blera për zbatimin e kësaj Direktive duhet të jenë në përputhje me metodën e referencës ose më të barasvlershmen e saj deri, më 11 qershor 2010.

Gjithë pajisjet e përdorura në matje fikse duhet të jenë në përputhje me metodën e referencës ose me të barasvlershmen e saj deri, më 11 qershor 2013.

E. Njohja e ndërsjelltë e të dhënave

Në zbatimin e llojit të miratimit për të treguar se pajisjet përmbushin kërkesat e performancës të metodës së referencës listuar në Seksionin A, autoritetet dhe njësitë kompetente të caktuara në përputhje me nenin 3, do të pranojnë raporte testesh lëshuar në Shtete të tjera Anëtare nga laboratorë të akredituar me EN ISO 17025, për të realizuar testime të tilla.

SHTOJCA VII

VLERAT E SYNUARA PËR OZONIN DHE OBJEKTIVAT AFATGJATA

A. Përkufizime dhe kritere

1. Përkufizime

AOT40 (shprehur në $(\mu\text{g}/\text{m}^3) \cdot \text{orë}$), nënkupton shumën e diferencës midis përqendrimeve njëorëshe më të mëdha se $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$ (= 40 pjesë për miliard) dhe $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$ gjatë një periudhe të dhënë duke përdorur vetëm vlerat njëorëshe matur midis orës 8.00 dhe 20.00 Ora e Evropës Qendrore (CET) çdo ditë.

2. Kriteria

Kriteret e mëposhtme do të përdoren për të kontrolluar vlefshmërinë gjatë mbledhjes së të dhënave dhe llogaritjes së parametrave statistikorë:

Parametri	Proporcioni i kërkuar për të dhëna të vlefshme
Vlera një-orëshe	75 % (d.m.th. 45 minuta)
Vlera tetë-orëshe	75 % e vlerave (d.m.th. gjashtë orë)
Mesatare maksimumi 8 orë ditore në bazë 8 orë pa ndërprerje	75 % e veprimit një-orësh mesatare tetë-orëshe (d.m.th. 18 mesatare tetëdhjetë-orëshe për ditë)
AOT 40	90 % e vlerave një orësh për periudhën kohore përcaktuar për llogaritjen e vlerës së AOT40 (1)
Mesatare vjetore	75 % e vlerave në një orë gjatë verës (Prill deri Shtator) dhe 75 % gjatë dimrit (Janar deri Mars, Tetor deri Dhjetor) stinët më vete
Numri i kapërcimeve të vlerave dhe vlerat maksimale në muaj	90 % e maksimumit ditor vlerat e mesatares tetë orëshe (27 vlerat ditore të disponueshme në muaj) 90 % e vlerave një-orëshe midis orës 8.00 dhe 20.00 CET
Numri i kapërcimeve të vlerave dhe vlerat maksimale në muaj	Pesë nga gjashtë muaj gjatë stinës së verës (Prill deri në Shtator)

(1) Në rastet ku nuk janë të mundura tërë të dhënat e matura të mundshme, do të përdoret faktori i mëposhtëm për të llogaritur vlerat AOT40:

$$\text{AOT40}_{\text{përcaktuar}} = \text{AOT40}_{\text{matur}} \times \frac{\text{totali i numrit të mundshme të orëve (*)}}{\text{numri i vlerave një-orëshe të matura}}$$

(*) numri i orëve brenda periudhës kohore të përkufizimit të AOT40, (d.m.th. ora 08:00 deri 20:00 CET nga data 1 maj deri më 31 korrik çdo vit, për mbrojtjen e bimësisë dhe nga 1 prill deri më 30 shtator çdo vit për mbrojtjen e pyjeve).

B. Vlerat e synuara

Objektivat	Periudha mesatare	Vlera e synuar	Data brenda të cilës duhet përmbushur vlera e synuar
Mbrojtja e shëndetit publik	Mesatare tetë-orë ditore maksimale (2)	120 µg/m ³ të mos kapërcehet në më shumë se 25 ditë për vit kalendarik e marrë me mesatare në tre vite (3)	1.1.2010
Mbrojtje bimësisë	Maj deri në korrik	AOT40 (llogaritur nga vlera 1 orë)	1.1.2010

18 000 $\mu\text{g}/\text{m}^3 \cdot \text{h}$ e
marrë në mesatare
në pesë vite(3)

(1) Përmbushja e vlerave të synuara do të përlllogaritet që nga kjo datë. Kjo do të thotë, viti 2010 do të jetë viti i parë i të dhënave për të cilin përdoren në llogaritjen e përmbushjes gjatë tre ose pesë viteve pasuese, sipas rastit.

(2) përqendrimi maksimal i mesatares tetë-orëshe ditore, do të përzgjidhet duke analizuar mesataren e tetë orëve rresht, llogaritur nga të dhëna një-orëshë dhe përditësuar çdo orë. Mesatarja e çdo tetë-orëshi e llogaritur në këtë mënyrë do të caktohet në ditën kur ajo mbaron, d.m.th. periudha e parë e llogaritjes për çdo një ditë do të jetë periudha nga ora 17:00 e ditës së mëparshme deri në orën 01:00 të asaj dite; periudha e fundit e llogaritjes për çdo një ditë, do të jetë periudha nga ora 16:00 deri në orën 24:00 të ditës.

(3) Nëse nuk mund të përcaktohen mesataret e tre ose pesë viteve në baze të një grupi të dhënash vjetore të plota dhe pasuese, të dhënat minimale vjetore të kërkuara për të kontrolluar përmbushjen e vlerave të synuara do të jetë si vijon:

— për vlerën e synuar për mbrojtjen e shëndetit publik: të dhëna të vlefshme për një vit,

— për vlerën e synuar për mbrojtjen e bimësisë: të dhëna të vlefshme për tre vjet.

C. Objektivat afatgjata

Objektiva	Periudha mesatare	Objektiva afatgjatë	Data brenda së cilës duhen arritur objektivat afatgjatë
Mbrojtja e shëndetit publik	Mesatare maksimale tetë-orëshe ditore	120 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	E papërcaktuar
Mbrojtja e bimësisë	Maj deri në korrik	AOT40 (llogaritur nga vlera 1 orë) 6 000 $\mu\text{g}/\text{m}^3 \cdot \text{h}$	E papërcaktuar

SHTOJCA VIII

Kritere për klasifikimin dhe vendosjen e pikave të marrjes së kampioneve për përlllogaritjet e përqendrimeve të ozonit

Zbatohen si më poshtë për matjet fikse:

A. Vendosja në shkallë makro

Lloji i stacionit	Objektivat e matjes	Përfaqësimi (1)	Kriteri i vendosjes në shkallë makro
Urban	Mbrojtja e shëndetit publik: Të përlllogarisë ekspozimin e popullsisë urbane ndaj ozonit,	Disa km ²	Larg ndikimit të çlirimit lokal të ndotjes si :trafiku, stacione karburanti, etj.;

	d.m.th. aty ku dendësia e popullsisë dhe përqendrimi i ozonit janë relativisht të larta dhe përfaqësuese të ekspozimit popullsisë së përgjithshme		Vende të rrahura ku mund të maten nivele të përziera mirë; Vende si zona të banuar dhe tregtare në qytete, parqe (larg pemëve), rrugë të mëdha ose sheshe me shumë pak ose aspak trafik, sipërfaqe të hapura tipike për vende edukimi, sportive, ose argëtimi Në njëfarë distance nga zona e ndotjeve maksimale, në drejtim nga fryn era kryesore gjatë kushteve të favorshme për formimin e ozonit; Atje ku popullsia, të korrat e ndjeshme ose ekosisteme natyrore të vendosura në anën e jashtme të grupimeve, janë të ekspozuar ndaj niveleve të larta të ozonit; Atje ku është e vlefshme, disa stacione në periferi urbane gjithashtu në drejtim të kundërt më erën në zona me çlirim maksimal ndotësish, në mënyrë që të përcaktohen nivelet rajonale të ozonit
Periferi urbane	Mbrojtje e shëndetit të njeriut dhe bimësisë: Të përlogarisë ekspozimin e popullsisë dhe bimësisë së vendosur në skaje të grupimeve, ku shfaqen nivelet më të larta të ozonit ndaj të cilave kanë prirje të ekspozohen drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt popullsia dhe bimësia	Disa dhjetëra km ²	

Rural	Mbrojtja e shëndetit publik dhe bimësisë: të përlogaritët ekspozimi i popullsisë, të korrave dhe ekosistemeve natyrore ndaj përqendrimeve të ozonit në shkallë nën-rajonale	Nivelet nën-rajonale (disa qindra km ²)	Stacionet mund të vendosen në vendbanime të vogla dhe/ose sipërfaqe me ekosisteme natyrore, pyje ose të korra; Përfaqësuese për ozonin larg ndikimit të çlirimit direkt të ndotësve lokalë, si p.sh. : përqendrime industriale dhe rrugët; Në sipërfaqe të hapura, po jo në majat e maleve më të larta,
Rrethina rurale	Mbrojtja e bimësisë dhe shëndetit publik: Të përlogaritët ekspozimi i të korrave dhe ekosistemeve natyrore ndaj përqendrimeve të ozonit në shkallë rajonale, si edhe ekspozim i popullsisë	Nivele kontinentale Rajonale/kombëtare (1 000 deri në 10 000 km ²)	Stacione të vendosura në sipërfaqe me dendësi popullore më të ulët, për shembull: ekosisteme natyrore, pyje, në një distancë prej së paku 20 km nga zonat urbane dhe industriale, dhe larg çlirimeve të ndotësve lokalë; Të shmangen vendet që janë objekt i formimeve lokale në rritje të kushteve shndërruese afër tokës, si edhe majat e maleve më të larta; Nuk këshillohen vendet bregdetare me cikle të theksuara ditore ere me karakter lokal,

(1) pikat e marrjes së kampioneve, ku është e mundur, duhet të jenë përfaqësuese të vendeve të ngjashme jo në afërsi të tyre të drejtpërdrejtë.

Për stacione rurale dhe rrethina rurale vendi, ku është e vlefshme, do të bashkërendohen me kërkesat e vëzhgimit të Rregullores së Komisionit (KE) nr 1737/2006 e datës 7 Nëntor 2006, që parashtrojnë rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullatorit (KE) nr 2152/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me vëzhgimin e pyjeve dhe ndërveprimeve mjedisore në Komunitet (1).

(1) GZ L 334, 30.11.2006, fq. 1.

B. Vendosje në shkallën mikro

Për aq sa është e praktikueshme, do të ndiqet procedura mbi vendosjen në shkallë mikro në Seksionin C të Shtojcës III, duke siguruar gjithashtu që provëza e marrjes të jetë pozicionuar larg nga burime të tilla si :furnalta dhe tuba të nxjerrjes së tymit dhe më shumë se 10 m nga rruga më e afërt, me distancën në rritje si funksion i intensitetit të trafikut.

C. Dokumentimi dhe rishikimi i përzgjedhjes së vendit

Do të ndiqen procedurat në Seksionin D të Shtojcës III, duke praktikuar vëzhgimin e përshtatshëm dhe interpretimin e të dhënave të monitorimit në kontekstin e proceseve meteorologjike dhe fotokimike, që ndikojnë në përqendrimet e ozonit matur në vendet përkatëse.

SHTOJCA IX

Kriteret për përcaktimin e numrit minimal të pikave të marrjes së kampioneve për matjet fikse të përqendrimeve të ozonit

A. Numri minimal i pikave të marrjes së kampioneve për matje fikse të vazhdueshme për të përlogaritur përmbushjen e vlerave të synuara, objektive afatgjata dhe pragjeve të informacionit dhe të alarmit atje ku matjet e tilla janë i vetmi burim informacioni

Popullsia (x 1 000)	Grupime (urbane dhe rrethina urbane) (1)	Zona të tjera (rrethina urbane dhe rurale) (1)	Sfondi rural
< 250		1	1 stacion
< 500	1	2	/50 000
< 1 000	2	2	km2 si
< 1 500	3	3	dendësi
< 2 000	3	4	mesatare
< 2 750	4	5	në të
< 3 750	5	6	gjitha
> 3 750	Një stacion shtesë për 2 milion banorë	Një stacion shtesë për 2 milion banorë	zonat në vend (2)

(1) së paku 1 stacion në zonat rrethina urbane, ku është i mundur të jetë ekspozimi më i lartë i popullsisë. Në grupime së paku 50 % e stacioneve do të vendoset në zona rrethina urbane.

(2) këshillohet 1 stacion për 25 000 km² për terrene komplekse.

B. Numri minimal i pikave të marrjes së kampioneve për matje fikse për zonat dhe grupimet që arrijnë objektivat afatgjata

Numri i pikave të marrjes së kampioneve për ozonin, në kombinim me mjete të tjera përlloraritje të shtuar, si për shembull :modelimin e cilësisë së ajrit dhe matjen e grupuar të dyoksidit të nitrogjenit, do të jenë të mjaftueshme për të testuar prirjen e ndotjes së ozonit dhe për të kontrolluar përputhjen me objektivat afatgjata. Numri i stacioneve të vendosura në grupime dhe zona të tjera mund të zvogëlohet në një të tretën e numrit të specifikuar në Seksionin A. Në rastet ku informacioni nga stacionet e matjeve fikse është burimi i vetëm i informacionit, do të mbahet të paktën një stacion këshillimi. Nëse, në zonat ku ka përlloraritje të shtuar, rezultati i kësaj është që zona nuk ka më stacion, bashkërendimi me numrin e stacioneve në zonat fqinje do të sigurojë përlloraritje të mjaftueshme të përqendrimeve të ozonit përkundrejt objektiveve afatgjata. Numri i stacioneve me sfond rural do të jetë një 100 000 km².

SHTOJCA X

MATJA E SUBSTANCAVE PARARENDËSE TË OZONIT

A. Objektivat

Objektivat kryesore të matjeve të tilla janë: të analizojnë çfarëdo prirjeje me pararendësit e ozonit, të kontrollojnë efikasitetin e strategjive për zvogëlimin e çlirimit të ndotësve, të kontrollojnë qëndrueshmërinë e inventarëve të çlirimit të ndotësve dhe të ndihmojnë në lidhjen e burimeve të çlirimit me përqendrimet e ndotjeve të vëzhguara.

Një synim tjetër është të mbështesë të kuptuarit e formimit të ozonit dhe proceset e shpërndarjes së paraprijësve, si edhe zbatimin e modeleve fotokimike.

B. Substancat

Matja e substancave pararendëse të ozonit do të përfshijnë së paku oksidet e nitrogjenit (NO dhe NO₂) dhe përbërje organike avulluese (VOC). Më poshtë jepet një listë e përbërjeve organike avulluese këshilluar për matje:

	1-butene	Isoprene	Benzinë etilike
Etan	Trans-2-butene	n-hexane	m + p-xylene
Etilen	Cis-2-butene	i-hexane	o-xylene
Acetilen	1,3-butadiene	n-heptane	1,2,4-trimetilëbenzinë
Propan	n-pentan	n-octane	1,2,3- trimetilebenzene
Propen	i-pentan	i-octane	1,3,5-trimetilëbenzinë
n-butan	1-pentene	Benzinë	Formaldehyde
i-butan	2-pentene	Toluene	Total hidrokarbone jo-metan

C. Vendosja

Do të merren masa, në veçanti, në sipërfaqe urbane dhe rrethina urbane në çdo vend vëzhgimi të ngritur në përputhje me kërkesat e kësaj Direktive dhe e konsideruar si e përshtatshme për sa i takon objektivave monitoruese përmendur në Seksionin A.

SHTOJCA XI

VLERAT KUFI PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT PUBLIK

A. Kriteria

Pa cenuar Shtojcën I, do të përdoren kriteret e mëposhtme për të kontrolluar vlefshmërinë e të dhënave totale dhe për të llogaritur parametrat statistikorë:

Parametrat	Proporcion i kërkuar i të dhënave të vlefshme
Vlerat një orëshe	75% (d.m.th. 45 minuta)
Vlerat tetë orëshe	75% e vlerave (d.m.th. 6 orë)
Mesatare maksimale 8-orëshë ditore	75% i mesatareve 8-orëshe në vijim orësh (d.m.th. mesatare 18 orëshe në ditë)
Vlerat 24-orëshe	75% i mesatareve me bazë orëshe (d.m.th. së paku vlera 18 orë)
Mesatare vjetore	90%(1) i vlerave një orëshe ose (nëse e padisponueshme) vlera në 24-orë gjatë vitit

(1) Kërkesat për llogaritjen e mesatares vjetore nuk përfshijnë humbje të dhënash si rezultat i kalibrimit të rregullt ose i mirëmbajtjes normale të mjeteve.

B. Vlerat kufi

Periudha mesatare	Vlera kufi	Kufiri i tolerancës	Data brenda së cilës duhet të përmbushet vlera kufi
Dyoksid sulfuri			
Një orë	350 µg/m ³ , të mos kapërcehet me më shumë se 24 herë për vit kalendarik	150 µg/m ³ (43 %)	___ (1)
Një ditë	125 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 3 herë për vit kalendarik	Asnjë	___ (1)
Dyoksid nitrogjeni			
Një orë	200 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 18 herë në vit kalendarik	50 % në 19 korrik 1999, pakësuar në 1 janar 2001 dhe çdo 12 muaj pas kësaj me përqindje të barabarta vjetore për të arritur 0 % në 1 janar 2010	1 janar 2010
Vit kalendarik	40 µg/m ³	50 % më 19 korrik	1 janar 2010

			1999, pakësuar në 1 janar 2001 dhe çdo 12 muaj pas kësaj me përqindje të barabarta vjetore për të arritur 0 % në 1 janar 2010	
Benzinë				
Vit kalendarik	5 µg/m ³		5 µg/m ³ (100 %) në 13 Dhjetor 2000, pakësuar në 1 janar 2006 dhe çdo 12 muaj pas kësaj me 1 µg/m ³ për të arritur 0 % në 1 janar 2010	1 janar 2010
Monoksid karboni				
Mesatare maksimale tetë orë ditore	10 mg/m ³	60%		___ (1)
Periudha mesatare	Vlera kufi	Kufiri i tolerancës		Data brenda së cilës duhet të përmbushet vlera kufi
Plumbi				
Viti kalendarik	0,5 µg/m ³ (3)	100%		___ (3)
PM10				
Një ditë	50 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 35 herë në vit kalendarik	50%		___ (1)
Viti kalendarik	40 µg/m ³	20%		___ (1)

(1) Në fuqi aktualisht që prej datës 1 janar 2005

(2) Përqendrimi maksimal i mesatares të tetë orëve ditore, do të përzgjidhet duke testuar mesataren e tetë orëve radhazi, llogaritur nga të dhëna mbi bazë orësh dhe përditësuar çdo orë. Çdo mesatare e tetë orëve e llogaritur kështu, do t'i caktohet ditës së cilës ajo mbaron d.m.th. periudha e parë e llogaritjes për çdo një ditë do të jetë periudha nga ora 17:00 në ditën e mëparshme deri në orën 01:00 të asaj dite; periudha e fundit e llogaritjes për çdo një ditë, do të jetë periudha nga ora 16:00 deri në 24:00 të asaj dite.

3) Në fuqi që nga data 1 janar 2005. Vlera kufi do të përmbushet vetëm, më 11 janar 2010 ,në afërsi të menjëhershme të burimeve industriale specifike vendosur në vende të ndotura nga dekada aktivitete industriale. Në raste të tilla, vlera kufi deri, më 1 janar 2010 do të jetë 1,0 µg/m³. Sipërfaqja në të cilën vlejné vlera kufi më të larta nuk duhet të zgjerohet përtej 1 000 m nga burime të tilla specifike.

SHTOJCA XII

PRAGJET E INFORMACIONIT DHE ALARMIT

A. Pragjet e alarmit për ndotës me përjashtim të ozonit

Të martën gjatë tre orëve të njëpasnjëshme në vende përfaqësuese të cilësisë së ajrit në mbi së paku 100 km² ose në një zonë ose grupim të tërë, cilado të jetë më e vogël.

Ndotësi	Pragu i alarmit
Dyoksidi i sulfurit	500 µg/m ³
Dyoksidi i nitrogenit	400 µg/m ³

B. Pragjet e informacionit dhe alarmit për ozonin

Qëllimi	Periudha mesatare	Pragu
Informacioni	1 orë	180 µg/m ³
Alarmi	1 orë (1)	240 µg/m ³

(1) Për zbatimin e nenit 24, kapërcimi i pragut do të matet ose parashikohet për tre orë të njëpasnjëshme.

SHTOJCA XIII

NIVELET KRITIKE PËR MBROJTJEN E BIMËSISË

Periudha e mesatare	Niveli kritik	Kufiri i tolerancës
Dyoksidi i sulfurit Viti kalendarik dhe dimri (1 tetor deri në 31 mars)	20 µg/m ³	Asnjë
Oksidet e nitrogenit	30 µg/m ³ NO _x	Asnjë

SHTOJCA XIV

SYNIMI KOMBËTAR I ZVOGËLIMIT TË EKSPOZIMIT, VLERA E SYNUAR DHE VLERA KUFI PËR PM_{2,5}

A. Treguesi mesatar i ekspozimit

Treguesi mesatar i ekspozimit i shprehur në µg/m³ (AEI), do të bazohet në matjen dhe në vendndodhje me sfond urban në zona dhe grupime përgjatë gjithë territorit të një Shteti Anëtar. Duhet të përllogaritet si përqendrim mesatar vjetor i matur në periudhë tre vite kalendarike pa ndërprerje mesatare, kjo e nxjerrë nga të gjitha pikat e marrjes së kampioneve të ngritura në zbatim të Seksionit B të Shtojcës V. AEI-ja për vitin e marrë për referencë 2010, do të jetë përqendrimi mesatar i viteve 2008, 2009 dhe 2010.

Megjithatë, në vendet ku nuk ka të dhëna për vitin 2008, Shtetet Anëtare mund të përdorin mesataren e përqendrimit të viteve 2009 dhe 2010, ose përqendrimin mesatar të viteve 2009, 2010 dhe 2011. Shtetet Anëtare që përdorin këto mundësi do t'i komunikojnë vendimin e tyre Komisionit deri, më 11 shtator 2008.

AEI-ja për vitin 2020 do të jetë përqendrimi mesatar vjetor i tre viteve pa ndërprerje nxjerrë në tërë pikat e marrjes së kampioneve për vitet 2018, 2019 dhe 2020. AEI-ja

përdoret për të analizuar nëse është përmbushur synimi kombëtar i zvogëlimit të ekspozimit.

AEI-ja për vitin 2015 do të jetë përqendrimi mesatar tre vjetor nxjerrë në të gjitha pikat e marrjes së kampioneve për vitet 2013, 2014 dhe 2015. AEI-ja përdoret për të analizuar nëse është përmbushur detyrimi i përqendrimit të ekspozimit.

B. Synimi kombëtar i zvogëlimit të ekspozimit

Synimi i zvogëlimit të ekspozimit përkatës ndaj AEI në vitin 2010	Synimi i zvogëlimit në përqindje	Viti brenda të cilit duhet arritur synimi i zvogëlimit të ekspozimit 2020
Përqendrimi nistor në $\mu\text{g}/\text{m}^3$		
$< 8,5 = 8,5$	0%	
$> 8,5 \text{ — } < 13$	10%	
$= 13 \text{ — } < 18$	15%	
$= 18 \text{ — } < 22$	20%	
≥ 22	Gjithë masat e duhura për të arritur $18 \mu\text{g}/\text{m}^3$	

Në vendet ku AEI-ja në vitin e marrë për referencë është $8,5 \mu\text{g}/\text{m}^3$ ose më pak synimi i zvogëlimit të ekspozimit do të jetë zero. Synimi i zvogëlimit do jetë gjithashtu zero në rastet ku AEI-ja arrin nivelin e $8,5 \mu\text{g}/\text{m}^3$ në çfarëdo momenti kohor gjatë periudhës nga viti 2010 në vitin 2020 dhe mbahet në atë nivel ose më poshtë.

C. Detyrimi i përqendrimit të ekspozimit

Detyrimi i përqendrimit të ekspozimit	Viti në të cilin do të arrihet vlera e detyrimit
$20 \mu\text{g}/\text{m}^3$	2015

D. Vlera e synuar

Periudha mesatare	Vlera e synuar	Data në të cilën do të arrihet vlera e synuar
Viti kalendarik	$25 \mu\text{g}/\text{m}^3$	1 janar 2010

E. Vlera kufi

Periudha mesatare	Vlera kufi	Kufiri i tolerancës	Data në të cilën do të arrihet vlera kufi
FAZA 1	$25 \mu\text{g}/\text{m}^3$	20 % në 11 qershor 2008, e ulur në 1 janarin tjetër dhe 12 muaj që prej	1 janar 2015

asaj date me
përqindje të
barabarta vjetore
për të arritur 0 %
në 1 janar 2015

FAZA 2 (1)

Viti kalendarik 20 µg/m³

1 janar 2010

(1) Faza 2 — vlera kufi treguese do të rishikohet nga Komisioni në vitin 2013 në dritën e informacionit të mëtejshëm mbi efektet në sendet dhe mjedis, mundësisë teknike dhe përvojës së vlerës së synuar në Shtetet Anëtare.

SHTOJCA XV

Informacioni që duhet përfshirë në planet kombëtare, rajonale e lokale për cilësinë e ajrit për përmirësim të cilësisë së ajrit të mjedisit

A. Informacioni që duhet siguruar sipas nenit 23 (planet e cilësisë së ajrit)

1. Lokalizimi i ndotjes me tepri

- (a) rajoni
- (b) qyteti (harta)
- (c) stacion matjeje (hartë, koordinata gjeografike)

2. Informacion i përgjithshëm

- (a) lloji i zonës (qytet, sipërfaqe industriale ose rurale)
- (b) vlerësimi zonës së ndotur (km²) dhe i popullsisë së ekspozuar ndaj ndotjes;
- (c) të dhëna të dobishme klimatike;
- (d) të dhëna përkatëse mbi topografinë;
- (e) informacion i mjaftueshëm mbi llojin e synimeve që kërkojnë mbrojtje në zonë

3. Autoritetet përgjegjëse

Emrat dhe adresat e personave përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të përmirësimit.

4. Natyra dhe përlllogaritja e ndotjes

- (a) përqendrime të vëzhguara gjatë viteve të mëparshme (përpara zbatimit të masave të përmirësimit);
- (b) përqendrime të matura që nga fillimi i projektit;
- (c) teknikat e përdorura për përlllogaritje

5. Origjina e ndotjes

- (a) lista e burimeve kryesore të çlirimit përgjegjës për ndotjen (hartë)
- (b) sasia totale e çlirimit nga këto burime (ton/vit);
- (c) informacion mbi ndotjen e importuar nga këto rajone.

6. Analizë e situatës

(a) detaje të faktorëve përgjegjës për kapërcimin (për shembull: transporti, përfshirë transportin ndërkuftar, formimi i ndotësve dytësorë në atmosferë);

(b) detaje të masave të mundshme për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

7. Detaje të masave ose projekteve që kanë ekzistuar përpara 11 qershorit 2008,d.m.th.:

- (a) masa ndërkombëtare, kombëtare, rajonale e lokale;
- (b) efektet e vëzhguara të këtyre masave.

8. Detaje të masave ose projekteve përshtatur me pikëpamjen e zvogëlimit të ndotjes në vijim të hyrjes në fuqi të kësaj Direktive:

- (a) listimi dhe përshkrimi i gjithë masave të vendosura në projekt;
- (b) programi kohor i zbatimit;
- (c) vlerësimi i planifikimit të përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe të kohës që mendohet të duhet për të arritur këto objektiva.

9. Detaje të masave dhe projekteve të planifikuara ose në kërkim për një periudhë afatgjate.

10. Listë e botimeve, dokumenteve, punës, etj., përdorur për të shtuar informacionin e kërkuar sipas Shtojcës.

B. Informacioni që duhet siguruar sipas nenit 22(1)

1. Gjithë informacioni sikurse është përcaktuar në Seksionin A.

2. Informacion në lidhje me statusin e zbatimit të Direktivave të mëposhtme:

1. Direktiva e Këshillit 70/220/KEE e 20 marsit 1970, në përfrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me masat që do merren kundër ndotjes së ajrit nga çlirimi i mjeteve me motor (1);
2. Direktiva 94/63/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 20 dhjetorit 1994 në lidhje me kontrollin çlirimeve nga përbërjet organike avulluese (VOC) nga magazinimi i naftës dhe shpërndarja e saj nga depot te pikat e karburantit (2);
3. Direktiva 2008/1/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 15 janarit 2008, në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së integruar(shkrirë) (3);
4. Direktiva 97/68/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 16 dhjetorit 1997 në lidhje me përfrimin e ligjeve në Shtetet Anëtare, që kanë të bëjnë me masat kundër çlirimit të ndotësve në masë gazi e të shkëputur për motora me djegie të brendshme që instalohen në makineri të lëvizshme jo rrugore (4);
5. Direktiva 98/70/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 13 tetorit 1998 në lidhje me cilësinë e naftës dhe karburanteve diesel (5);
6. Direktiva e Këshillit 1999/13/KE e 11marsit 1999 mbi kufizimin e përbërjeve organike avulluese si rezultat i përdorimit të shkrirësve organikë në aktivitete dhe instalime të caktuara (6);
7. Direktiva e Këshillit 1999/32/KE e datës 26 prill 1999 në lidhje me zvogëlimin e karburanteve të caktuar të lëngshëm në përmbajtjen e sulfurit (7);
8. Direktiva 2000/76/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 4 dhjetorit 2000 në lidhje me djegien e mbetjeve (8);

9. Direktiva 2001/80/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 23 tetorit 2001 mbi kufizimin e çlirimeve të ndotësve të caktuar në ajër nga fabrika të mëdha djegjeje;
10. Direktiva 2001/81/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 23 tetorit 2001 në lidhje me vlerat tavan kombëtare të çlirimit për ndotës të caktuar atmosferikë;
-

11. Direktiva 2004/42/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 21 prillit 2004 mbi kufizimin e çlirimit të përbërjeve organike avulluese, si rezultat i përdorimit të shkriësve organikë në disa bojëra, llake dhe produkte mjetesh (1);

12. Direktiva 2005/33/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 6 korrikut 2005 Direktivën 1999/32/KE për sa i përket përmbajtjes sulfurike të karburanteve detare (2);

13. Direktiva 2005/55/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 28 shtatorit 2005 në lidhje me përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare që lidhen me masat që do merren kundër çlirimit të ndotësve në masë gazi e të shkëputur nga motorat e kompresion-ndezjes për përdorim në automjete dhe çlirimit të ndotësve në masë gazi nga motora për ndezje pozitive që punojnë me gaz natyror ose naftë të lëngëzuar për përdorim në automjete (3);

14. Direktiva 2006/32/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 5 prillit 2006 në efikasitetin e përdorimit final të energjisë dhe shërbimeve të energjisë (4).

3. Informacion mbi gjithë masat për pakësimin e ndotjes së ajrit që janë konsideruar në nivele të përshtatshme lokale, rajonale e kombëtare për zbatim, në lidhje me arritjen e objektivave të cilësisë së ajrit, përfshirë:

(a) zvogëlimin e çlirimit nga burime stacionare duke siguruar që burimet djegëse ndotëse stacionare të vogla dhe mesatare (përfshirë për biomasë) të jenë të pajisura me mjete që kontrollojnë çlirimin ose të zëvendësohen;

(b) zvogëlimin e çlirimeve nga automjete nëpërmjet pajisjes së kontrollit të çlirimit në pjesën e pasme. Duhet të merret parasysh përdorimi i shtysave ekonomike për të nxituar nismëmarrjen;

(c) prokurimi nga ana e autoriteteve publike, i automjeteve, pajisje karburanti dhe djegiejeje në linjë me udhëzuesin mbi prokurimin publik mjedisor, për të reduktuar çlirimet, përfshirë blerjen e:

— automjete të reja, përfshirë mjete më çlirim të ulët,

— shërbime transporti me mjete më të pastra,

— burime djegiejeje stacionare me çlirim të ulët,

— karburante me çlirim të ulët për burime stacionare dhe të lëvizshme,

(d) masa për të kufizuar çlirimet e transportit nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të trafikut (përfshirë çmimin për bllokim, tarifa parkimi të diferencuara ose nxitje të tjera ekonomike; përcaktimi i zonave me çlirim të ulët);

(e) masa për të inkurajuar zhvendosje të transportit drejt mënyrave më pak ndotëse;

(f) të sigurohet përdorimi i karburanteve me çlirim të ulët në burime stacionare mesatare e të mëdha dhe në burime të lëvizshme;

(g) masa për të zvogëluar ndotjen e ajrit nëpërmjet sistemit të lejimit nën Direktivën 2008/1/KE, planet kombëtare nën Direktivën 2001/80/KE dhe nëpërmjet përdorimit të instrumenteve ekonomike, si për shembull: taksa, gjoba ose këmbim çlirimi.

(h) aty ku është e përshtatshme, masa për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve ose të grupeve të tjera të ndjeshme.

SHTOJCA XVI INFORMIMI PUBLIK

1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që t'i bëhet rregullisht e mundur publikut, informacioni i përditësuar në lidhje me përqendrimet e ndotësve në mjedis, ndotës të përfshirë në këtë Direktivë.

2. Përqendrimet e parashikuara të mjedisit do të paraqiten si vlera mesatare sipas periudhës së përshtatshme të mesatares siç parashtrohet në Shtojcën VII dhe Shtojcat XI deri në XIV. Informacioni duhet së paku të tregojë çfarëdo nivelesh që kapërcejnë objektiva të cilësisë së ajrit përfshirë vlera kufi, vlera të synuara, pragje të alarmit, pragje të informacionit ose objektiva afatgjata për ndotës të përfshirë në rregullore. Duhet të sigurojë gjithashtu një përlllogaritje të shkurtër në lidhje me objektivat e cilësisë së ajrit dhe informacion, të përshtatshëm, që ka të bëjë me efektet mbi shëndetin, ose, atje ku është e vlefshme, bimësinë.

3. Informacioni mbi përqendrimet në mjedis të dyoksidit të sulfurit, dyoksidit të nitrogjenit, lëndës së shkëputur (së paku PM10), ozon dhe monoksid karboni do të përditësohet në së paku bazë ditore dhe kudo që është e praktikueshme, informacioni do të përditësohet në bazë ore. Informacioni për përqendrimet në mjedis të plumbit dhe benzinës, paraqitur si vlerë mesatare për 12 muajt e fundit, do të përditësohet në bazë tre-mujore dhe në bazë mujore, kudo që kjo është e praktikueshme.

4. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të bëhet publik në kohë informacioni përreth kapërcimeve faktike apo të parashikuara të pragjeve të alarmit. Detajet e dhëna duhet të përfshijnë së paku informacionin e mëposhtëm:

(a) informacion mbi kapërcimet e vëzhguara:

— vendi i sipërfaqes së kapërcimit,

— lloji i pragut të kapërcyer (informacioni apo alarmi),

— koha e nisjes dhe kohëzgjatja e kapërcimit,

— përqendrimi më i lartë në një orë dhe ,përveç kësaj,përqendrimi mesatar më i lartë në tetë orë, në rastin e ozonit;

(b) parashikimi për pasditen/ditën/t vijuese:

— sipërfaqja gjeografike e kapërcimeve të pritshme të pragut të informacionit dhe/ose alarmit,

— ndryshime të pritshme në ndotje (përmirësim, stabilizim ose përkeqësim), së bashku me arsyet për ato ndryshime;

(c) informacion mbi llojin e popullsisë së përfshirë, efekte të mundshme mbi shëndetin dhe sjellje e këshiluar:

— informacion mbi grupet e popullsisë në rrezik,

— përshkrim i simptomave që kanë gjasa të shfaqen,

— masat paraprake të zvogëluara që duhet të merren nga popullsia e përfshirë,

— ku mund të gjendet informacion i mëtejshëm;

(d) informacioni mbi veprimet parandaluese për të zvogëluar ndotjen dhe/ose ekspozimin ndaj saj: tregues të sektorëve të burimeve kryesore; këshillime për masa për të zvogëluar çlirimet;

(e) në rastin e kapërcimeve të parashikuara, Shtetet Anëtare do të marrin masa për të siguruar që detaje të tilla të jenë siguruar në masa të praktikueshme.

SHTOJCA XVII

TABELA E KORRELACIONIT

Kjo	Direktiva 96/62/KE	Direktiva 1999/30/KE	Direktiva 2000/69/KE	Direktiva 2002/3/EC
Direktivë				
Neni 1	Neni 1	Neni 1	Neni 1	Neni 1
Neni 2(1)deri (5)	Neni 2(1)deri (5)	---	---	---
Neni 2(6) dhe (7)	---	---	---	---
Neni 2(8)	Neni 2(8)	Neni 2(7)	---	---
Neni 2(9)	Neni 2(6)	---	---	Neni 2(9)
Neni 2(10)	Neni 2(7)	Neni 2(6)	---	Neni 2(11)
Neni 2(11)	---	---	---	Neni 2(12)
Neni 2(12) dhe (13)	---	Neni 2(13) dhe (14)	Neni 2(a) dhe (b)	---
Neni 2(14)	---	---	---	Neni 2(10)
Neni 2(15) dhe (16)	Neni 2(9) dhe (10)	Neni 2(8) dhe (9)	---	Neni 2(7) dhe (8)
Neni 2(17) dhe (18)	---	Neni 2(11) dhe (12)	---	---
Neni 2(19),(20),(21),(22) dhe (23)	---	---	---	---
Neni 2(24)	---	Neni 2(10)	---	---
Neni 2(25) dhe (26)	Neni 6(5)	---	---	---
Neni 2(27)	---	---	---	Neni 2(13)
Neni 2(28)	---	---	---	Neni 2(3)
Neni 3 me përjashtim paragrafin (1)(f)	Neni 3	---	---	---
Neni 3(1)(f)	---	---	---	---
Neni 4	Neni 2(9) dhe (10), Neni 6(1)	---	---	---
Neni 5	---	Neni 7(1)	Neni 5(1)	---
Neni 6(1) deri (4)	Neni 6(1) deri (4)	---	---	---
Neni 6(5)	---	---	---	---
Neni 7	---	Neni 7 pikat (2) dhe (3) ndryshimet	Neni 5 pikat (2) dhe (3) ndryshimet	---
Neni 8	---	Neni 7 pika (5)	Neni 5 pika (5)	---
Neni 9	---	---	---	Neni 9(1)

				nënparagrafi i parë dhe i dytë
Neni 10	---	---	---	Neni 9(1)deri (3) me ndryshimet
Neni 11(1)	---	---	---	Neni 9(4)
Neni 11(2)	---	---	---	---
Neni 12	Neni 9	---	---	---
Neni 13(1)	---	Nenet 3 pika (1),4 pika (1),5 pika (1) dhe 6	Nenet 3 pika (1) dhe 4	---
Kjo Direktivë	Direktiva 96/62/KE	Direktiva 1999/30/KE	Direktiva 2000/69/KE	Direktiva 2002/3/EC
Neni 13(2)	---	Nenet 3 pika (2) dhe 4 pika (2)	---	---
Neni 13(3)	---	Neni 5 pika (5)	---	---
Neni 14	---	Nenet 3 pika (1) dhe 4 pika (1) me ndryshimet	---	---
Neni 15	---	---	---	---
Neni 16	---	---	---	---
Neni 17(1)	---	---	---	Nenet 3 pika (1) dhe 4 pika (1)
Neni 17(2)	---	---	---	Neni 3 pikat (2) dhe (3)
Neni 17(3)	---	---	---	Neni 4 pika (2)
Neni 18	---	---	---	Neni 5
Neni 19	Neni 10 me ndryshimet	Neni 8 pika (3)	---	Neni 6 me ndryshime
Neni 20	---	Nenet 3 pika (4) dhe 5 pika (4) me ndryshimet	---	---
Neni 21	---	---	---	---
Neni 22	---	---	---	---
Neni 23	Neni 8 pikat (1) deri (4) me ndryshimet	---	---	---
Neni 24	Neni 7 pika (3) me ndryshimet	---	---	Neni 7 me ndryshimet
Neni 25	Neni 8 pika (5) me ndryshimet	---	---	Neni 8 me ndryshimet
Neni 26	---	Neni 8 me ndryshimet	Neni 7 me ndryshimet	Neni 6 me ndryshimet
Neni 27	Neni 11 me ndryshimet	Neni 5 pika (2) nënparagrafi i dytë	---	Neni 10 me ndryshimet
Neni 28(1)	Neni 12 pika (1) me ndryshimet	---	---	---
Neni 28(2)	Neni 11 me ndryshimet	---	---	---
Neni 28(3)	---	---	---	---
Neni 28(4)	---	Shtojca IX me ndryshimet	---	---
Neni 29	Neni 12 pika (2)	---	---	---

Neni 30	---	Neni 11	Neni 9	Neni 14
Neni 31	---	---	---	---
Neni 32	---	---	---	---
Neni 33	Neni 13	Neni 12	Neni 10	Neni 15
Neni 34	Neni 14	Neni 13	Neni 11	Neni 17
Neni 35	Neni 15	Neni 14	Neni 12	Neni 18
Shtojca I	---	Shtojca VIII ndryshimet	me Shtojca VI	Shtojca VII
Shtojca II	---	Shtojca V ndryshimet	me Shtojca III	---
Shtojca III	---	Shtojca VI	Shtojca IV	---
Shtojca IV	---	---	---	---
Shtojca V	---	Shtojca VII ndryshimet	me Shtojca V	---
Shtojca VI	---	Shtojca IX ndryshimet	me Shtojca VII	Shtojca VIII
Shtojca VII	---	---	---	Shtojca I, Shtojcë III seksioni II
Shtojca VIII	---	---	---	Shtojca IV
Shtojca IX	---	---	---	Shtojca V
Shtojca X	---	---	---	Shtojca VI
Shtojca XI	---	Shtojca I, seksioni I, Shtojca II, seksioni I Dhe Shtojca III (me ndryshimet); Shtojca IV (i pandryshuar)	Shtojca II, Shtojca II	---
Shtojca XII	---	Shtojca I, seksioni II, Shtojca II, seksioni II,	---	---
Shtojca XIII	---	Shtojca I, seksioni I, Shtojca II, seksioni I	---	---
Shtojca XIV	---	---	---	---
Shtojca XV	Shtojca IV	---	---	---
Seksioni A				
Shtojca XV	---	---	---	---
Seksioni B				
Shtojca XVI	---	Neni 8	Neni 7	Neni 6 ndryshimet

DEKLARATË NGA KOMISIONI

Komisioni i kushton vëmendje tekstit të miratuar nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian për Direktivën mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe për ajër më të pastër për Evropën. Në veçanti, Komisioni vëren rëndësinë e dhënë nga Parlamenti Evropian dhe Shtetet Anëtare në nenin 22 pika (4) dhe përshkrimin 16 të masave komunitare për uljen e çlirimit të ndotësve të ajrit në burim.

Komisioni merr parasysh nevojën për të zvogëluar çlirimin e ndotësve të dëmshëm të ajrit, nëse bëhet progres i konsiderueshëm, në drejtim të objektivave të përcaktuara në Programin e Gjashtë Mjedisor të Veprimit. Komunikimi i Komisionit në lidhje me një strategji tematike mbi ndotjen e ajrit paraqet një numër të konsiderueshëm masash të

mundshme të Komisionit. Është bërë progres domethënës mbi këto dhe masa të tjera që nga miratimi i strategjisë:

— Këshilli dhe Parlamenti kanë miratuar tashmë një legjislacion të ri që kufizon çlirimin e tymrave nga mjete për transport të lehtë;

— Komisioni ka miratuar propozimin për një legjislacion të ri, që të përmirësohet efektshmëria e legjislacionit të Komunitetit për ndotje industriale, përfshirë ngritjet intensive bujqësore dhe masat për të përballuar burimet e djegiejeve industriale në shkallë të vogël;

— Komisioni ka miratuar propozimin për një legjislacion të ri, që kufizon çlirimin e tymrave të motorrave të instaluar në mjetet e transportit të rëndë;

— në vitin 2008 Komisioni parashikon propozime të reja ligjore që:

— do të zvogëlojnë më tej çlirimet kombëtare të lejuara në Shtetet Anëtare për ndotës kyç,

— do të zvogëlojnë çlirimet lidhur me rimbushjen e makinave me benzinë në pikat e karburantit,

— do të shqyrtojë përmbajtjen e sulfurit në karburante, përfshirë ato detare,

— do të bëjnë punë përgatitore në zhvillimin për të hetuar mundësinë e:

— e përmirësimit të ekoprojektimit dhe zvogëlimit të çlirimeve të bolierëve shtëpiakë dhe ngrohësve me ujë,

— zvogëlimin e përmbajtjes shkrirëse të bojërave, llakeve dhe produkteve për lyerjen e makinave,

— zvogëlimin e çlirimit të tymrave të makinerive të lëvizshme jo rrugore dhe si rezultat në rritjen e përfitimit nga karburante jo rrugorë me pak sulfur, propozuar tashmë nga Komisioni,.

— Komisioni vazhdon gjithashtu të shtyjë për zvogëlime thelbësore të çlirimit nga anije në Organizatën Ndërkombëtare Detare dhe është i përkushtuar të paraqesë propozime për masa Komunitare, nëse IMO nuk arrin të sjellë propozime, sa duhet ambicioze, siç parashikohet në vitin 2008.

Megjithatë, Komisioni është i përkushtuar ndaj qëllimeve të iniciativës së tij 'Rregullore më e Mirë' dhe nevojës për propozime të mbështetura nga një përlllogaritje e përgjithshme në lidhje me ndikimet dhe përfitimet. Në këtë aspekt dhe në përputhje me Traktatin që Themelon Komunitetin Evropian, Komisioni do të vazhdojë të vlerësojë nevojën për të paraqitur propozime të reja ligjore, por e rezervon të drejtën e vet, për të vendosur nëse do të jetë e përshtatshme ,dhe kur, për t'i paraqitur propozime të tilla.

DEKLARATË NGA HOLLANDA

Holanda ka mbështetur gjithmonë zhvillimin e politikave ambicioze evropiane dhe efikase në lidhje me cilësinë e ajrit ,dhe do të vazhdojë të bëjë të njëjtën gjë, dhe në të ardhmen. Si rezultat, ajo është e kënaqur me kompromisin e pranuar nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian dhe përgëzon Parlamentin, Komisionin dhe Presidencën për rezultatet e arritura. Direktiva e re në lidhje me cilësinë e ajrit në mjedis, shënon progres ,domethënës, si për mjedisin edhe për shëndetin publik.

Siç veçoi Holanda kur u hartua Pozicioni i përbashkët, cilësia e ajrit në vendin tonë ndikohet shumë nga zhvillimet ndërkufitare dhe si rezultat do të përfitojë vërtet shumë nga një metodë efikase evropiane. Shqetësimi kryesor i Holandës ka qenë që Direktiva të përmbajë një paketë të ekuilibruar masash evropiane dhe kombëtare, si

edhe kufij kohorë realistë për të arritur synimet e cilësisë së ajrit. Vetëm atëherë Shtetet Anëtare do të jenë në gjendje të arrijnë synimet ambicioze që janë vendosur.

Holanda është e kënaqur me deklaratën e Komisionit për paraqitjen e masave Komunitare në kohë. Me kohë, pajtimi i mbarë KE me standardet e cilësisë së ajrit do të varet nga politika të arsyeshme evropiane, që do të merren me ndotjen në burim. Holanda do të shënonte, në veçanti, mungesën e të dhënave dhe pasigurinë mbizotëruese përreth çlirimit dhe përqendrimit të lëndës së imët shkëputëse (PM_{2,5}). Ajo ,natyrisht, do të bëjë çfarëdo përpjekje për të përmbushur objektivat e Direktivës brenda datës së synuar. Në bazë të njohurisë që zotërojmë aktualisht, kjo do të jetë gjerësisht e mundshme. Qeveria holandeze po zhvillon një Program Bashkëpunimi Kombëtar për Cilësinë e Ajrit, për t'u marrë me vende ku tavanet e çlirimit janë kapërcyer vazhdueshëm, në mënyrë që edhe atje të përmbushen standardet brenda datës së synuar.

Holanda është e kënaqur që Këshilli dhe Parlamenti Evropian përfunduan leximin e tyre të dytë në kohën, që Direktiva të hyjë në fuqi që në fillim të vitit 2008. Kjo është thelbësore për programin tonë kombëtar si edhe për veprimet në vendet rreth nesh. Holanda do të punojë shumë për të siguruar, që programi i bashkëpunimit kombëtar dhe gjithë masat lokale dhe rajonale, të jenë të mjaftueshme.

(1) GZ C 195, 18.8.2006, fq. 84.

(2) GZ C 206, 29.8.2006, fq. 1.

(3) Mendimi i Parlamentit Evropian, datë 26 shtator 2006

(GZ C 306 E, 15.12.2006, fq. 102), qëndrimi i përbashkët i Këshillit, datë 25 qershor 2007 (GZ C 236 E, 6.11.2007, fq. 1) dhe qëndrimi i Parlamentit Evropian, datë 11 dhjetor 2007. Vendimi i Këshillit 14 prill 2008.

4) GZ L 242, 10.9.2002, fq. 1.

(5) GZ L 296, 21.11.1996, fq. 55. Direktiva e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr. 1882/2003 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (GZ L 284, 31.10.2003, fq. 1).

6) GZ L 163, 29.6.1999, fq. 41. Direktiva ndryshuar nga Komisioni (Vendimi 2001/744/KE (GZ L 278, 23.10.2001, fq. 35).

7) GZ L 313, 13.12.2000, fq. 12.

(8) GZ L 67, 9.3.2002, fq. 14.

(9) GZ L 35, 5.2.1997, fq. 14. Vendimi i ndryshuar nga Vendimi i Komisionit 2001/752/KE (GZ L 282, 26.10.2001, fq. 69).

(10) GZ L 23, 26.1.2005, fq. 3.

(11) GZ L 171, 27.6.1981, fq. 11.

(12) GZ L 309, 27.11.2001, p. 22. Direktiva e ndryshuar nga Direktiva e Këshillit 2006/105/KE (GZ L 363, 20.12.2006, fq. 368).

(13) GZ C 321, 31.12.2003, fq. 1.

(14) GZ L 184, 17.7.1999, p. 23. Vendimi i ndryshuar nga Vendimi 2006/512/KE (GZ L 200, 22.7.2006, fq. 11).

(15) GZ L 76, 6.4.1970, fq. 1. Direktivë ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2006/96/KE (GZ L 363, 20.12.2006, fq. 81).

(16) GZ L 365, 31.12.1994, fq. 24. Direktivë e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr 1882/2003 (GZ L 284, 31.10.2003, fq. 1).

(17) GZ L 24, 29.1.2008, fq. 8.

(18) GZ L 59, 27.2.1998, fq. 1. Direktivë e ndryshuar, së fundmi ,nga Direktiva 2006/105/KE

(19) GZ L 350, 28.12.1998, fq. 58. Direktivë e ndryshuar, së fundmi, nga Rregullorja (KE) N 1882/2003.

(20) GZ L 85, 29.3.1999, fq. 1. Direktivë e ndryshuar, së fundmi, nga Direktiva 2004/42/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (GZ L 143, 30.4.2004, fq. 87).

(21) GZ L 121, 11.5.1999, fq. 13. Direktivë e ndryshuar, së fundmi, nga Direktiva 2005/33/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (GZ L 191, 22.7.2005, fq. 59).

(22) GZ L 332, 28.12.2000, fq. 91.

(23) GZ L 143, 30.4.2004, fq. 87.

(24) GZ L 191, 22.7.2005, fq. 59.

(25) GZ L 275, 20.10.2005, fq. 1. Direktivë e ndryshuar së fundmi nga Rregullorja (KE) nr 715/2007

(26)GZ L 171, 29.6.2007, fq. 1).

(27) GZ L 114, 27.4.2006, fq. 64.